



Kryeministri Rama nderon me “Yllin e Madh të Mirënjohjes Publike”, gjeneralin e NATO-s

Kryeministri Edi Rama i dorëzoi në Tiranë, medaljen “Ylli i Madh i Mirënjohjes Publike”, Komandantit të Komandës Operacionale të NATO-s, gjeneral Tod Daniel Wolters. Rama i dorëzoi medaljen e lartë gjeneralit Wolters me motivacionin: “Me mirënjohjen e thellë për vizionin, kontributin dhe bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe për mbështetjen e rolit të Shqipërisë në ruajtjen e paqes e sigurisë

rajonale”. Në fjalën e tij, Kryeministri Rama tha: “Gjenerali ka një vend të posaçëm, nuk po e them këtë për shkak të rrethanave apo rasti e do se duhet t’i them ca fjalë. Ishim ne që donim këtë, nuk na u kërkuva ta bënim këtë gjë, ndonjëherë na kërkohet siguri, ndonjëherë duam ne diçka, dhe donim që të shprehnim përgëzimet tona posaçërisht gjeneralit Wolters, si një prej personave më të shquar që ka përfaqësuar në

më të mirën e vet këtë marrëdhënie”. “Gjenerali Wolters veçanërisht, jo vetëm ka qenë mbështetës, por edhe i prirur të tregojë me vepra e jo me fjalë që e ka për zemër këtë marrëdhënie dhe fjala ‘për zemër’ është diçka që e vlerësoj shumë, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtij vendi që në fund të fundit kanë të bëjnë me njerëzit. Forcat e Armatosura kurrë nuk do të harrojnë se ishte pikë...”

» faqe 2



KOMANDANTI WOLTERS, VIZITE LAMTUMIRE NE SHQIPERI

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Mirënjohje për kontributin e dhënë në modernizimin e FA-ve



Shqipëria do të pajiset me një nga sistemet më të mira raketore antitank “Javelin”

Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të kenë pjesë të tyre një nga sistemet më të mira raketore antitank “Javelin”. Lajmi u konfirmua nga vetë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “Është në kuadrin e modernizimit të FA-së, rritjes së kapaciteteve tona, plotësimit të objektivave që Shqipëria ka në raport me NATO-n. Sistemi raketor antitank “Javelin” po prodhohet nga kompania amerikane, më e madhja në botë e industrisë ushtarake, “Lockheed Martin”...



» Faqe 3

FA në ndihmë të komunitetit, në fshatin Zall-Torrë të njësisë Proptisht në bashkinë e Pogradecit

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip “Bailey” me gjatësi 54 m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Kjo urë u ndërtua mbi lumin Shkumbin në fshatin Zalltore, Njësia Administrative, Proptisht, Bashkia Pogradec. Në inspektimin e punimeve ishte i pranishëm ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përgëzoi Kompaninë e Urave për punën e tyre të palodhur: “Jam i kënaqur që sot inaugurojmë këtë urë, që bën të mundur, pothuajse për 4000 banorë, t’iu shkurtohet rruga me thujse...”



» Faqe 4

Gjeneral major Begaj: SHBA i jep Shqipërisë 17 milionë dollarë për ushtrinë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor, prof. asoc Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Pentagon, ku u prit nga kryetari i Shefave të Shtabeve të Bashkuara të SHBA-së gjeneral Mark A. Milley si dhe shefi i Shtabit të Forcave Tokësore gjeneral James C. McConville. Gjeneral Milley pasi i uroi mirëseardhjen në Pentagon, gjeneralmajor Begajt, u shpreh se SHBA vlerësojnë maksimalisht rolin dhe kontributin e Shqipërisë si partner strategjik dhe anëtare e denjë e NATO-s. Gjeneral Milley theksoi se, solidariteti dhe kohezioni që Shqipëria ka treguar në të gjitha vendimmarrjet...



» Faqe 5

PLAZHE MË TË PASTRA, MINISTRI PELESHI: NË GJITHË ZONËN BREGDETARE POR EDHE LIQENORE JANË ANGAZHUAR 750 TRUPA TË FA-së

Kryeministri Edi Rama: Numrit më të lartë të turistëve do t'i përgjigjemi me plazhe më të pastra

Plani i Pastrimit Kombëtar për t'i dhënë dorën e fundit pastrimit të bregdetit përpara datës 1 qershor edhe me ndihmën e forcave të ushtrisë u ndoq nga kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu dhe ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro. Kryeministri Rama ndoqi nga afër momente nga aksioni i pastrimit në territor. Rama siguroi se: “numrit më të lartë të turistëve do t'i përgjigjemi me plazhe më të pastra”.

“Besoj se ky do të jetë sezoni më i pastër, edhe për shkak të punës së jashtëzakonshme që është bërë edhe për shkak të suportit financiar që është vendosur për t'i ardhur në ndihmë bashkive bregdetare, të cilat përjetojnë në sezonin turistik shumëfishimin e popullsisë dhe një ngarkesë ekstra që nuk përballohet dot me tarifat normale që kanë”, -u shpreh Rama. Kryeministri theksoi se: “është thelbësore që të gjithë të marrin pjesë në këtë përpjekje, ku nëse nga ana e bashkisë ka përpjekje për ta pastruar, të tjerët duhet të përipiqen për të mos ndotur”.



“Ky është elementi i parë i abetares së patriotizmit, të mos ndotim shtëpinë tonë. Do të vazhdojmë t'i rrimë mbi kokë kësaj pune, derisa të mbyllet gjithë sezoni, i cili me të gjitha gjasat do të jetë edhe sezoni me fluksin më të madh dhe me konsumin më të madh”, -tha ai. Ministrja Kumbaro u ndal te puna e madhe që është bërë gjatë këtyre 6 muajve. Sipas saj, sfida

mbetet ndryshimi i sjelljes së qytetarëve sepse, siç tha ajo: “ne i pastrojmë dhe ata kthehen prapë dhe ndotin ambientin”. “Sfida më e madhe është puna që na duhet të bëjmë me ndryshimin e mentalitetit. Kjo është beteja e këtij mandati”, -tha ministrja. Nga ana e tij, ministri Peleshi theksoi se në gjithë zonën bregdetare por edhe liqenore janë angazhuar 750 trupa.



“Kemi forca të shumta për të krijuar një dorë të fundit të pastrimit të territorit”, -tha ai. Për të mundësuar një Shqipëri të pastër e dinjitoze u ndërmor Plani Kombëtar i Pastrimit, i cili nisi më 7 nëntor 2021 në Vlorë dhe ka përfshirë të gjithë territorin e vendit nga veriu deri në jug.

Plani i pastrimit ka vijuar pa u ndalur për muaj me radhë në çdo cep të territorit, sepse nuk është një aksion por një operacion sistematik e i gjatë, të cilit i duhet shkuar deri në fund.

Ndonëse sezoni turistik nisi zyrtarisht në maj, puna ka filluar që në tetor në një bashkëpunim të ngushtë midis instancave bashkiake, ministrive, subjekteve private dhe qytetarëve. “Në Durrës, ku vijon Plani i Pastrimit Kombëtar për t'i dhënë dorën e fundit pastrimit të bregdetit përpara datës 1 qershor edhe me ndihmën e forcave të ushtrisë, numrit më të lartë

të turistëve i përgjigjemi me plazhe më të pastra”, -shkroi gjithashtu ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në profilin e tij në rrjetin social. “Të bashkuar jo të ndarë”, -thekson ai. Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, tha për mediat se: “Forcat e Armatosura janë të angazhuara në maksimum në këtë aksion kombëtar ku po marrin pjesë për të mundësuar një Shqipëri të pastër dhe dinjitoze, në bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjithë strukturat e pushtetit vendor (prefekturat e bashkitë), në zonat e përcaktuara për pastrim.

Aktualisht ato janë të dislokuara përgjatë gjithë bregdetit dhe kryesisht në spotet më kyçe të vendit, duke marrë në konsideratë sezonin turistik dhe fluksin e pritshëm të pushuesve vendas e të huaj”, -tha ajo.

KRYEMINISTRI RAMA NDERON ME “YLLIN E MADH TË MIRËNJOHJES PUBLIKE”, GJENERALIN E NATO-s

Plan për bazë detare të NATO-s në Shqipëri

Kryeministri Edi Rama i dorëzoi në Tiranë, medaljen “Ylli i Madh i Mirënjohjes Publike”, Komandantit të Komandës Operacionale të NATO-s, gjeneral Tod Daniel Wolters.

Rama i dorëzoi medaljen e lartë gjeneralit Wolters me motivacionin: “Me mirënjohjen e thellë për vizionin, kontributin dhe bashkëpunimin me Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe për mbështetjen e rolit të Shqipërisë në ruajtjen e paqes e sigurisë rajonale”.

Në fjalën e tij, Kryeministri Rama tha: “Gjenerali ka një vend të posaçëm, nuk po e them këtë për shkak të rrethanave apo rasti e do se duhet t'i them ca fjalë. Ishim ne që donim këtë, nuk na u kërkuar ta bënim këtë gjë, ndonjëherë na kërkohet sigurisht, ndonjëherë duam ne diçka, dhe donim që të shprehim përgëzimet tona posaçërisht gjeneralit Wolters, si një prej personave më të shquar që ka përfaqësuar në më të mirën e vet këtë marrëdhënie”.

“Gjenerali Wolters veçanërisht, jo vetëm ka qenë mbështetës, por edhe i prirur të tregojë me vepra e jo me fjalë që e ka për zemër këtë marrëdhënie dhe fjala ‘për zemër’ është diçka që e vlerësoj shumë, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtij vendi që në fund të fundit kanë të bëjnë me njerëzit. Forcat e Armatosura kurrë nuk do të harrojnë se ishte pikë së pari gjenerali Wolters që qysh prej ditës së parë mbështeti transformimin e bazës ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të



NATO-s, si dhe mbështeti që prej ditës së parë Shqipërinë si një prej vendeve pritëse të stërvitjes “Defender Europe”, -theksoi Rama.

Kreu i qeverisë u shpreh se: “ishte gjenerali Wolters, që përkrahu dhe mbështeti qysh prej ditës së parë që Shqipëria të kishte selinë e forcave të speciale të komandës së SHBA-së në Europë”.

Më tej, Rama tha se: “është hera e parë kjo që personi që nderojmë sot është ‘Gjenerali’, për mua nuk është hera e parë, por ndoshta e fundit që

kam privilegjin të dekoroj një gjeneral. Gjenerali u tregua shumë i sjellshëm duke më thënë që ka marrë çdo yll e medalje që shteti amerikan mund t'i jepte. Shtimi i një tjetër embleme në uniformën e tij është një privilegj i jashtëzakonshëm. Ky është një moment për të kremtuar miqësinë e çmuar me aleancën më të çmuar që ky vend ka pasur fatin të ketë që është miqësia dhe aleanca me SHBA-të”.

“Miq të tanë europianë ndiejnë një lloj kureshtie se si ndodh që Shqipëria e shqiptarët janë pro-amerikanë. Jam i

sigurt, që nëse disa prej tyre nuk janë familjarizuar me historinë tonë mund t'u dukemi budallenj. Por jo, ne mund të jemi gjithçka, por nuk jemi budallenj. Ne jemi këtu në këtë pjesë historie të lidhur kaq fort me këtë aleat e këtë mik, falë edhe një pjese tjetër të historisë që ndërpreu këtë marrëdhënie, e cila këtë vit shënon 100-vjetorin e saj. Është 100-vjetori i marrëdhënieve shqiptaro-amerikane që e patën pikënisjen 100 vjet më parë, si njohje zyrtare në nivel marrëdhënie diplomatike, por që u ndeshën me gjysmë shekulli heshtje nga pala amerikane dhe gjysmë shekull zhurmë të stërmadhe nga ana jonë. Pasi, duke qenë krejtësisht e izoluar dhe që u shndërrua gati në “Korenë e Veriut” të Europës asokohe, ne e nisëm atje ku e lamë në vitin 1991 dhe tashmë është vendosur një gur themeli i ri, ku ne mund të kremtojmë raportin më të thellë e të frytshëm, raportin mes SHBA-ve dhe Shqipërisë”, -nënvizoi Rama.

“Ndoshta Forcat e Armatosura janë shprehja më e mirë e rugëtimit tonë për të mësuar, shoqëruar, nga miqtë e aleatët amerikanë, brenda NATO-s dhe në nivel dypalësh. Nëse sot Forcat tona të Armatosura kanë shkuar në një nivel që edhe ata më optimistët nuk do të kishin mundur ta përfytyronin 10, 20 apo 30 vjet më parë, kjo ka ndodhur falë miqve e aleatëve tanë amerikanë”, -u shpreh kreu i qeverisë.

Nga ana tjetër, -vijoi Rama, -nëse kemi qenë në gjendje të kuptojmë

ngadalë, por me vendosmëri se kemi potencial për të shfaqur në aleancë së bashku me të gjithë nxitjen e shtysën e saj për të luftuar për atë që është e drejtë, kjo është së pari e mbi të gjitha, rrjedhojë e inkurajimit, fuqisë dhe solidaritetit që kemi pasur mundësi të perceptojmë nga miqtë dhe aleatët tanë amerikanë.

Kryeministri Rama tha se: “kemi disa ide të mira, dhe ajo që është më rëndësi, kemi disa miq të mirë dhe jemi shumë besimplotë që mund të gjejmë vendin tonë për të qenë vlerë e shtuar në këtë aleancë”.

“E lashë për këtë moment që t'i them Gjeneralit që nesër do të kemi mundësi t'i tregojmë disa prej ideve dhe në këto kohë mjaft specifike, mjaft të rrezikshme ai do të konsiderojë, ndoshta nuk është ide e keqe, për të pasur një bazë detare të fjalës së fundit të NATO-s në Shqipëri. Na takon t'i paraqesim projektin atij dhe t'i tregojmë për çfarë kemi punuar dhe më pas ai sërish qysh prej fillimit do të jetë avokati dhe mbështetësi i kësaj ideje”, -tha Rama.

Duke iu referuar luftës në Ukrainë, kryeministri Rama deklaroi se: “jemi radhitur në anën e duhur të historisë dhe jemi qysh kemi qenë që në krye të herës, të pozicionuar krah aleancës për të qenë kudo e kurdo është nevoja, në momentin e duhur në vendin e duhur për të luftuar çdo forcë që kërcënon jetesën tonë, botën e cilës i besojmë, të ardhmen e brezave që vijnë”.

Komandanti Wolters, vizitë lamtumire në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Mirënjohje për kontributin e dhënë në modernizimin e FA-ve

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi priti në një takim lamtumire komandantin Suprem të Fuqive Aleate në Europë, gjeneral Tod Wolters.

Pasi i uroi mirëseardhjen, ministri Peleshi e falënderoi gjeneralin Wolters për kontributin dhe përkushtimin e tij, jo vetëm gjatë periudhës 3-vjeçare si Komandant Suprem i Fuqive Aleate në Europë, por edhe për sakrificat dhe dedikimin, përgjatë gjithë karrierës së tij të spikatur 40-vjeçare, karrierë e mbyllur me sukses në detyrën ndoshta më të lartë për një ushtarak.

Gjithashtu, zoti Peleshi vuri në dukje dhe e përgëzoi gjeneralin Wolters për liderhipin e treguar gjatë kësaj periudhe të trazuar, mes pasigurive në të cilat po kalon kontinenti ynë, duke dëshmuar edhe një herë solidaritetin, unitetin dhe vendosmërinë e Aleancës për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të saj, vlerat demokratike dhe lirinë e popujve të saj, të fituara nëpërmjet përpjekjeve të shumfishta.

Më tej, ministri Peleshi u ndal te roli që gjeneral Wolters ka luajtur në



mbështetje të Forcave të Armatosura të RSH, në kuadër të modernizimit të tyre, rritjes së kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë. Shembulli konkret i kësaj mbështetjeje dhe vëmendjeje, ishte zhvillimi në vendin

tonë i stërvitjes “Defender Europe 21”, të cilën gjeneral Wolters pati rastin ta inspektojë nga afër, por dhe për zhvillimin e projektit të NATO-s për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës.



KOMANDANTI WOLTERS

Gjeneral Wolters ka luajtur në mbështetje të Forcave të Armatosura të RSH, në kuadër të modernizimit të tyre, rritjes së kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë. Shembulli konkret i kësaj mbështetjeje dhe vëmendjeje, ishte zhvillimi në vendin tonë i stërvitjes “Defender Europe 21”, të cilën gjeneral Wolters pati rastin ta inspektojë nga afër, por dhe për zhvillimin e projektit të NATO-s për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës.

SHQIPËRIA DO TË PAJSET ME NJË NGA SISTEMET MË TË MIRA RAKETORE ANTITANK “JAVELIN”

Ministri Peleshi: Raketa antitank “Javelin”, në kuadër të modernizimit të FA-ve dhe plotësimit të objektivave ndaj NATO-s

Forcat e Armatosura të Shqipërisë do të kenë pjesë të tyre një nga sistemet më të mira raketore antitank “Javelin”. Lajmi u konfirmua nga vetë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “Është në kuadrin e modernizimit të FA-së, rritjes së kapaciteteve tona, plotësimit të objektivave që Shqipëria ka në raport me NATO-n. Sistemi raketor antitank “Javelin” po prodhohet nga kompania amerikane, më e madhja në botë e industrisë ushtarake, “Lockheed Martin”, dhe ne kemi bërë porositë tonë aty si pjesë e rrugëtimit tonë për forcimin e FA-së, modernizimit, rritjes së sigurisë dhe mbrojtjes territoriale të vendit tonë. Nuk është se ka ndonjë kërcënim konkret, që mos të krijojmë panik, ne jemi një vend në NATO, ne kemi zgjidhur çështjen e sigurisë kombëtare, jemi të mbrojtur, sepse na mbron neni 5 i traktatit të NATO-s, sipas të cilit hapësira e NATO-s është e paprekshme, por ne natyrisht do të vazhdojmë të ndjekim ritmin e NATO-s për t’u forcuar si pjesë e një aleance defensive”, - u shpreh ministri Peleshi.

Veç këtij sistemi, sipas ministrit të Mbrojtjes, do të ketë edhe blerje të tjera apo donacione nga partneri strategjik i Shqipërisë, SHBA apo nga partnerë të tjerë në NATO. Sipas



ministrit të Mbrojtjes: “Sado që NATO është e fuqishme, nuk është kërcënim për botën, nuk është kërcënim për Rusinë, nuk është kërcënim për rajonin, sepse është një forcë jo ofensive, nuk ka qëllim të sulmojë, por ka për qëllim të garantojë mbrojtje. Forcimi i NATO-s do të thotë dekurajim i fuqive të tjera, shpeshherë jo kaq pozitive, dhe rivalët tanë të vlerave politike, t’i shkurajojë në përpjekjet për t’u kthyer në politika të shekujve të kaluar, ndarjes së hartave apo ligjit që bën më i madhi në krahasim me të voglin”. I pyetur në lidhje me kërkesën për anëtarësim të Suedisë dhe Finlandës në NATO, ministri i Mbrojtjes tha se vendi ynë do të përkrahë linjën e Aleancës. “Ne jemi një aleat i vogël në NATO, por që gjithmonë jemi dhe do të jemi në linjë me partnerët tanë strategjikë, SHBA-të, të cilët janë dhe orientuesit e linjës që ne i përkrahim në raport me zhvillimet e NATO-s. Një nga politikat e NATO-s që ne e mbështesim është politika e “dyerve të hapura”, kështu që Suedia dhe Finlanda

janë dy shtete sovraane të pavarura me standarde të larta politike dhe ligjore, por dhe standarde ushtarake”, - theksoi ministri i Mbrojtjes. Sipas tij, Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor u intereson të promovojnë sa më shumë politikën e “dyerve të hapura”, në mënyrë që të shtohet ritmi i negociatave të anëtarësimit të rajonit, jo vetëm si një rrugë për forcimin e demokracisë, shtetit ligjor e prosperitetit, por edhe të sigurisë që pas 24 shkurtit është shtuar në të gjitha proceset. “Një Ballkan perëndimor i integruar plotësisht në BE dhe NATO, përfshirë këtu natyrisht edhe Kosovën edhe Bosnjën, edhe vende të tjera, do të thotë një siguri më e lartë për rajonin tonë, i cili për hir të së vërtetës është i brishtë dhe brishtësia vjen pikë së pari se proceset tona integruuese dhe politika e “dyerve të hapura” nuk ka gjetur zbatimin në rajonin tonë. Pra, ne jemi mbështetës të zjarrtë të politikës së hapur të NATO-s dhe BE-së edhe për shkaqet tona të brendshme apo rajonale”, - theksoi ministri Peleshi.

MBAHET TAKIMI I GRUPIT TË KONTAKTIT PËR UKRAINËN, QË DREJTOHET NGA SHBA

Ministri Peleshi: Mbështetja e pakursyer e Shqipërisë në dimensionin politiko - diplomatik, humanitar dhe ushtarak

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takim të Grupit të Kontaktit për Ukrainën, i cili u mbajt nëpërmjet video-konferencës.

Takimi u zhvillua nën drejtimin e sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së, z. Lloyd Austin dhe është në vijimësi të takimit që u mbajt në Bazën Ajrore të Ramstein, në Gjermani, më 26 prill 2022.

Ashtu si në takimin e parë të datës 26 prill edhe në këtë takim, morën pjesë ministra të Mbrojtjes dhe përfaqësues nga afro 44 vende të ndryshme. Pjesëmarrësit u përditësuan mbi situatën aktuale në Ukrainë, progresin e deritanishëm të donacioneve si dhe koordinimet përkatëse për sa i përket përmirësimit të kapaciteteve mbrojtëse të Ukrainës.

Ministrat dhe organizatorët nën-



vizuan rëndësinë që mbartin takime të kësaj natyre, duke ripërsëritur faktin se vetëm nëpërmjet konsultimeve të këtyre niveleve, punës së përditshme dhe koordinimeve të vazhdueshme, do të arrijmë të mbështesim Ukrainën sa dhe si duhet, në këtë përpjekje ekzistenciale të tyre.

Ministria e Mbrojtjes konfirmon edhe një herë mbështetjen dhe angazhimin e Shqipërisë në dimensionin politiko - diplomatik, humanitar dhe atë praktik ushtarak.

Takimi i radhës i Grupit të Kontaktit për Ukrainën u ra dakord të mbahet në mes të muajit qershor, kur pritet edhe një mbledhje e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s.

Forcat e Armatosura në ndihmë të komunitetit, në fshatin Zall-Torrë të njësisë Proptisht në bashkinë e Pogradecit

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip "Bailey" me gjatësi 54 m, seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton. Kjo urë u ndërtua mbi lumin Shkumbin në fshatin Zalltore, Njësia Administrative, Proptisht, Bashkia Pogradec.

Në inspektimin e punimeve ishte i pranishëm ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përgëzoi Kompaninë e Urave për punën e tyre të palodhur: "Jam i kënaqur që sot inaugurojmë këtë urë, që bën të mundur, pothuajse për 4000 banorë, t'iu shkurtohet rruga me thuajse 25 km për në shërbimet e tyre apo rrugës nacionale, sepse kjo rrugë përveç banorëve të zonës bën të mundur aksesin në potenciale të fshehura turistike siç është ura e Golikut. Kompania e Urave do të ketë gjithmonë vëmendjen dhe mbështetjen e duhur në kontributin e tyre të vyer ndaj komunitetit në nevojë", -do të shprehej ministri Peleshi

Të pranishëm në inaugurimin e urës ishin dhe shefi Shtabit të Komandës Mbështetëse kolonel Arben Dhuli, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra, kryetari Bashkisë Pogradec, Ilir Xhangolli si dhe administratori i zonës së Proptisht, Ramiz Pura.

Më pas fjalën e mori komandanti i Batalionit të Xhenios kolonel Hajdar Gurra i cili u shpreh se lidhja e këtyre zonave rurale nëpërmjet urave "Bailey" janë një tregues i qartë i mbështetjes së Forcave të Armatosura për popullsinë në çdo situatë nevojë, mbështetje e cila do të vijojë në çdo rast që të jetë e nevojshme.

Ndërtimi i kësaj ure është i një rëndësie të veçantë nga pikëpamja sociale



dhe ekonomike në shërbim të një komuniteti prej rreth 4000 banorësh, sepse kjo urë bën të mundur lidhjen e fshatrave: Zalltore, Selishtë, Baribardhë, Slatinjë, Manastrec, Dritas, Stranik, Farret dhe Stravaj. Gjithashtu bën të mundur lidhjen e katër shkollave 9-vjeçare, 2 shkollave të

mesme si dhe 8 qendra, gjithashtu bënë lidhjen me rrugën nacionale Librazhd - Pogradec si dhe rrugën e re Qukës - Qaf Pllaç, duke iu mundësuar lehtësi në përfitimin e shërbimit shëndetësor sa më të shpejtë e në lëvizje të popullsisë së kësaj zone.

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH, GJENERALMAJOR, PROF. ASOC. BAJRAM BEGAJ, VIZITË ZYRTARE NË UASHINGTON, SHBA

Gjeneral major Begaj: SHBA i jep Shqipërisë 17 milionë dollarë për ushtrinë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Pentagon, ku u prit nga kryetari i Shëfave të Shtabeve të Bashkuara të SHBA-së gjeneral Mark A. Milley si dhe shefi i Shtabit të Forcave Tokësore gjeneral James C. McConville.

Gjeneral Milley pasi i uroi mirëseardhjen në Pentagon, gjeneralmajor Begajt, u shpreh se SHBA vlerëson në maksimalisht rolin dhe kontributin e Shqipërisë si partner strategjik dhe anëtare e denjë e NATO-s. Gjeneral Milley theksoi se, solidariteti dhe kohezioni që Shqipëria ka treguar në të gjitha vendimarrjet e NATO-s, si dhe kontributi aktiv dhe pjesëmarrja në misione dhe operacione të NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara e bëjnë Shqipërinë një partner strategjik të rëndësishëm për SHBA-të.

Në vijim gjeneral Milley falënderoi Shqipërinë për kontributin që ka dhënë dhe po jep për Ukrainën si në planin politik - diplomatik, ashtu edhe lehtësimin e procedurave për pritjen e refugjatëve dhe ndihmat ushtarake.

Gjeneralmajor Begaj falënderoi gjeneral Milley-in për ftesën dhe zhvillimin e këtij takimi në këtë kohë ku siguria në Europë është e kërcënuar nga agresioni rus ndaj Ukrainës.

Gjeneralmajor Begaj bëri me dije se takimi ndërmjet kryetarit të Shëfave të Shtabeve të Bashkuara të SHBA dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH zhvillohet për herë të parë në historinë e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe mbart vlera historike. Vizita është produkt i bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet dy vendeve dhe forcave tona të armatosura dhe Shqipëria është krenare për këtë partneritet strategjik. Gjeneralmajor Begaj



vlerësoi maksimalisht mbështetjen e vazhdueshme dhe ndihmën që SHBA ka dhënë dhe po jep për Shqipërinë dhe FARSH, për transformimin, modernizimin, trajnimin, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve ushtarake. Në vijim të takimit u diskutua për një sërë çështjesh me interes të përbashkët.

Ndërkohë në takimin me gjeneral McConville diskutimi u fokusua në mbështetjen që SHBA-të po japin me trajnues dhe këshillues ushtarak

(SFAB), asistencë e SHBA-së në sektorin e Sigurisë dhe Mbrojtjes, roli i Shqipërisë si vend pritës për stërvitjet dhe trajnimet në shkallë të gjerë si dhe kontributet në mbështetje për operacionet e NATO-s. Gjatë vizitës në Pentagon, gjeneralmajor Begaj bëri nderime dhe vendosi një kurorë tek Memoriali i Usharit të Panjohur, në varrezat kombëtare të SHBA-së, në Arlington pranë Washingtonit.

Ndërkohë, në fund të vizitës

gjeneralmajor Begaj u intervistua nga Zëri Amerikës mbi takimin me Shefin e Shëfave të Shtabit të Bashkuar të ushtrisë amerikane, gjeneralin Milley, ku gjeneralmajor Begaj tregoi entuziazmin për bashkëpunimin 30-vjeçar me aleatin tonë strategjik NATO, si dhe programet e modernizimit, të cilat kanë qenë në bashkëpunim me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit. I pyetur mbi nisma diplomatike por edhe nga ana ushtarake ndaj Ukrainës, gjeneralmajor Begaj tha se: “qeveria shqiptare ka shprehur gatishmërinë për të mbajtur refugjatët ukrainas dhe ka dhënë ndihma humanitare të llojeve të ndryshme. Në planin ushtarak kjo mbështetje është realizuar përmes donacioneve të bëra nga qeveria shqiptare, të cilat janë lloje të ndryshme municionesh të cilat ne i kemi pasur në përdorim dhe stok në depot tona të forcave të armatosura”.

I pyetur mbi fondet që japin Shtetet e Bashkuara lidhur me Ukrainën dhe lidhur me sigurinë se ku konsiston kjo ndihmë nga Shtetet e Bashkuara për Shqipërinë, shefi i shtabit të FA-së, gjeneralmajor Begaj do shtonte se: “ne kemi një zyrë bashkëpunimi ushtarak me Shtetet e Bashkuara, e cila gjendet në Ministrinë e Mbrojtjes shqiptare dhe kjo zyrë koordinon të gjitha buxhetet, të cilat jepen nga shteti amerikan

për të ndihmuar forcat e armatosura shqiptare. Këto buxhete ndahen në dy kategori. Një buxhet janë grantet të cilat janë falas, për të rritur fuqinë mbrojtëse të vendit dhe një kategori tjetër, e cila është me buxhete të përbashkëta, të cilat ndihmojnë në fuqizimin e kapaciteteve tona mbrojtëse. Dhe këtë radhë shteti amerikan ka akorduar një buxhet grant prej 17 milionë dollarësh për të rritur fuqinë mbrojtëse të forcave të armatosura dhe për të rritur kapacitetet mbrojtëse. E theksoj që çdo buxhet i modernizimit të forcave të armatosura shqiptare, shkon për të rritur aftësitë tona mbrojtëse. Ne nuk kemi asnjë synim për agresion apo për t'i shpallur luftë dikujt. Ne jemi thjesht në atë çfarë kërkonte NATO si aleancë, që të bëjmë mbrojtje dhe shkurajim për çdo armik apo për çdo kundërshtar.”

Me interes ishte dhe përgjigjja ndaj pyetjes mbi një nga kontratat e fundit të qeverisë amerikane, që gjithashtu përfshin Shqipërinë, siç është pajisja me sisteme raketash “Javelin”, për të cilën gjeneral Begaj do shuante kureshtjen se: “Shqipëria do të marrë nga kompania “Lockheed Martin” një sasi me raketa kundërajrore të tipit “Javelin”, të cilat do të rrisin fuqinë tonë mbrojtëse kundërajrore. Siç e përmenda dhe më parë ky lloj furnizimi me këto produkte ushtarake do të rrisë fuqinë mbrojtëse të vendit dhe asnjëherë nuk do të jetë për qëllime të tjera, kështu që do të jetë vetëm për qëllime mbrojtëse dhe si kapacitete që mund të përdoren kudo dhe kurdoherë që do të kërkojë aleanca.”

Mbi situatën që është krijuar në Europë, dhe se si e ka ndryshuar mënyrën se si përgatiten anëtarët e ushtrisë shqiptare, jo vetëm nga ana ushtarake, fizike, por edhe moralisht, psikologjikisht, gjeneral Begaj do të shprehej se: “situata e cila ndodhi në Ukrainë, është një situatë e cila është vlerësuar realisht nga forcat e armatosura shqiptare. Jemi të fokusuar në rritjen e përgjegjshmërisë së forcave të armatosura shqiptare, për të bërë detyrën sa më mirë, për t'u përkushtuar sa më mirë dhe për të krijuar ato kapacitete operacionale që nevojiten në rastet e një ndodhie të tillë. Shpresojmë që Ballkani Perëndimor, pavarësisht se është një situatë e vlerësuar e qetë, por është një rajon që është i brishtë dhe ne duhet të jemi shumë mirë të fokusuar. Dhe për këtë forcat e armatosura dhe shteti shqiptar e bëjnë detyrën shumë mirë, është eksportues i paqes. Ne kemi kontribuar në operacione dhe misione të ndryshme të aleancës dhe në Kosovë, në KFOR ne kemi trupat tona të cilat janë atje duke marrë pjesë në misione çdo gjashtë muaj dhe kontributet tona në NATO, jo vetëm në KFOR janë të mirëpritura nga NATO.”



SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH GJENERALMAJOR PROF. ASOC. BAJRAM BEGAJ MORI PJESË NË TAKIMIN E KOMITETIT USHTARAK TË NATO-S

Gjeneralmajor Begaj: Shqipëria ka angazhuar gjithë instrumentet e saj në mbështetje të Ukrainës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në Takimin e 187-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Bruksel, Belgjikë.

Takimi i Komitetit Ushtarak u hap nga kryetari i Komitetit Ushtarak, admiral Rob Bauer, i cili theksoi se NATO është aleanca më e suksesshme në histori, së pari për aftësinë për të qenë të bashkuar, dhe së dyti për aftësinë e saj për të ndryshuar. Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm, z. Jens Stoltenberg, në fjalën e tij evidentoi ndryshimin e mjedisit të sigurisë, si pasojë e luftës brutale dhe të paprovokuar të Rusisë në Ukrainë, duke e përshkruar atë si mjaft të rrezikshme dhe të paprecedentë për sigurinë Euroatlantike. "Presidenti Putin po dështon në arritjen e objektivave strategjike. Ukraina po reziston, NATO mbetet e fortë dhe uniteti transatlantik është solid" - u shpreh sekretari Stoltenberg.

Takimi vijoi më tej me sesionet kushtuar luftës në Ukrainë; partnerët Finlandë dhe Suedi; vlerësimi operacional i komandantit Suprem të Aleatëve për Europën, gjeneral Tod Wolters dhe vlerësimi i Komandantit Suprem të Aleatëve për Transformimin, gjeneral Philippe Lavigne mbi konceptin e ardhshëm të Zhvillimit të Luftës si dhe Udhëzimin Politik 23, si dhe situata në rajonin indo-paqësor dhe roli



i Australisë, Japonisë, Zelandës së Re dhe Republikës së Koresë. Ndërkohë, në seancën e fundit u zhvillua takim privat midis shefave të Mbrojtjes për të shkëmbyer mendime të hapura për çështje

strategjike.

Gjeneralmajor Begaj në ndërhyrjen e tij theksoi qëndrimin e Shqipërisë kundër agresionit rus ndaj Ukrainës dhe mbështetjen që Shqipëria ka dhënë dhe vijon të



japë. Gjeneralmajor Begaj i bëri me dije Komitetit Ushtarak se: "Shqipëria në koordinim të ngushtë me aleatët ka angazhuar instrumentet e saj politike, diplomatike dhe ushtarake për të mbështetur Ukrainën. Ne kemi dhënë ndihmë në materiale luftarake dhe humanitare për Ukrainën dhe aktualisht po planifikojmë të

dërgojmë një sasi tjetër donacionesh. Komiteti Ushtarak është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s".



Aktiviteti "Ditët e Detarisë" u zhvillua në Galerinë "Art Saranda", në të cilën u paraqit një ekspozitë me fotografi, dokumente, piktura dhe botime historike.

Zhvillohet ditë e hapur me rastin e "Ditëve të Detarisë", Sarandë

Në bashkëpunim me Bashkinë e Sarandës dhe Forcën Detare, në qytetin e Sarandës u zhvillua aktiviteti "Ditët e Detarisë", me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Sarandë Ardian Gurma, zëvendëskomandantit të Forcës Detare kapiten i Rangut I Ferdinand Kreshpani, me përfaqësues dhe veteranë të Flotës Luftarake, Flotës Tregtare, përfaqësues të Forcës Detare, gjithashtu edhe pjesëmarrës gjimnazistë të qytetit të

Sarandës për të ndjekur këtë aktivitet.

Aktiviteti u zhvillua në Galerinë "Art Saranda", në të cilën u paraqit një ekspozitë me fotografi, dokumente, piktura dhe botime historike. U ndërruan me "Certifikatë Mirënjohje" (pas vdekjes), simboli i detarisë sarandjote, Gaqe Lepuri dhe disa veteranë të detarisë. Pjesëmarrësit vizituan edhe anijen e Forcës Detare "Butrinti" të ankoruar në portin e qytetit, e cila ishte e hapur për vizitorët gjatë gjithë ditës deri në mbrëmje.



Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë zyrtare në Forcën Detare të Belgjikës

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, zhvilloi vizitë zyrtare në Belgjikë, me ftesë të komandantit të Forcës Detare të Belgjikës kundëradmiral Jan De Beurme.

Delegacioni shqiptar u prit nga komandanti i Forcës Detare të Belgjikës dhe mori pjesë në paradën detare të organizuar me rastin e festimit të 75-vjetorit të Themelimit të Forcës Detare të Belgjikës. Në këtë event mori pjesë edhe shkëlqesia e tij, mbreti i Belgjikës Philippe Léopold Louis Marie si dhe të ftuar të tjerë vendas dhe të huaj.

Kundëradmiral Agastra zhvilloi një vizitë dhe në Qendrën e Trajnimit



të Luftës Detare me Mina gjatë së cilës u shoqërua nga komandanti i Forcës Detare të Belgjikës. Gjatë vizitës në këtë qendër, delegacioni u njoh me kapacitetet stërvitore, trajnuese dhe teknologjinë moderne në përdorim nga Forca Detare e Belgjikës.

Gjatë zhvillimit të këtyre ak-

tiviteteve, midis komandantëve të forcave detare u diskutua mbi fushat e bashkëpunimit të përbashkët midis dy tyre për të ardhmen. Fokusi i bashkëpunimit dypalësh do të jetë zhvillimi i kapaciteteve të Forcës Detare shqiptare në lidhje me krijimin e Grupit për Operacionet Detare të Luftës me Mina në Ujëra Shumë të Cekëta.

Më tej, kundëradmiral Adnand Agastra ftoi homologun e tij të zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri me qëllim vijimin e bashkëpunimit të mëtejshëm bilateral.



Kolonel Kuli

“Përfunduar sot me sukses kurset bazë dhe të avancuar të nënoficerit KBNO/f dhe KANO/f, fazën e dytë, në specialitetin “Forcë Ajrore”, kurse institucionale këto që shërbejnë si kushte për marrjen e gradave “Tetar” dhe “Rreshter” në Forcën Ajrore.

Baza Ajrore Kuçovë

Përfundon kursi Bazë dhe i Avancuar i nënoficerit në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore (QSFAj), me dislokim në Bazën Ajrore Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kurseve Bazë dhe të Avancuar të nënoficerit, (KBNO/f dhe KANO/f), faza e dytë, në specialitetin “Forcë Ajrore”.

Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, kolonel Adrian Kuli, komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Olldashi, nënoficeri i Forcës Ajrore kapter Aida Guxha, kursantët si dhe instruktorët e kësaj qendre. Në fjalën e tij, shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, kolonel Kuli theksoi se: “Përfunduar sot me sukses kurset bazë dhe të avancuar të nënoficerit KBNO/f dhe KANO/f, fazën e dytë, në specialitetin “Forcë Ajrore”, kurse institucionale këto që shërbejnë si kushte për marrjen e gradave “Tetar” dhe “Rreshter” në Forcën Ajrore. Gjithashtu, Kolonel Kuli në fjalën e tij falënderoi kursantët nënoficerë si dhe stafin e Qendrës



Stërvitore për angazhimin e përbashkët, punën, përkushtimin, përgjegjëshmërinë, seriozitetin dhe disiplinën e treguar gjatë 8 javëve të realizimit të programeve mësimore dhe stërvitore me këta kursantë, kontribut i përbashkët ky, i cili u pasqyrua qartë edhe në re-

zultatet e larta të arritura nga kursantët jo vetëm në lëndë specifike por edhe në testimin final në përfundim të kurseve. Një falënderim i veçantë u bë për komandën dhe shtabin e Forcës Ajrore si edhe për Bazën Ajrore Kuçovë, të cilat bëjnë të mundur sigurimin infrastruk-



turës së duhur për krijimin e kushteve normale për jetesë, trajnim dhe stërvitje të personelit kursant të ardhur nga repartet e ndryshme të Forcës Ajrore si dhe nga forcat e tjera. Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për kursantët e të dy kurseve. Kurset

Bazë dhe të Avancuar të Nënoficerit të Forcës Ajrore (KBN/Of dhe KAN/Of), u zhvilluan në 8 javë mësimore ku në total përfshijnë 240 orë mësimore, arsimim/stërvitje dhe praktikë, si në Qendrën Stërvitore ashtu edhe në repartet e Forcës Ajrore.

TAKIMI I KOMITETIT TË AVIACIONIT TË NATO-S

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në takimin e Komitetit të Aviacionit të NATO-s në Romë

U zhvillua në Romë Takimi i Komitetit të Aviacionit të NATO-s me përfaqësues të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s, si dhe organizata ndërkombëtare dhe institucione të tjera të rëndësishme civile dhe ushtarake që operojnë në sektorin e aviacionit.

Takimi u kryesua nga Dr. Giorgio Cioni, drejtor i Armatimeve dhe Kapaciteteve të Hapësirës Ajrore në Divizionin e Investimeve të Mbrojtjes së NATO-s. Takimi u zhvillua vetëm disa javë përpara Samitit të ardhshëm të NATO-s në Madrid në fund të qershorit. Mandati i Komitetit të Aviacionit është të mbështesë përpjekjet e Aleancës për të vazhduar përshtatjen ndaj skenarëve të sigurisë që ndryshojnë me shpejtësi në një hapësirë ajrore gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlikuar. Në takimin e Komitetit të Aviacionit të NATO-s, delegacioni shqiptar u përfaqësua nga drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. Maksim Et'hemaj dhe komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj.

Takimi hapi perspektivë të reja për bashkëpunimin e ardhshëm civilo-ushtarak në sektorin e avi-



acionit, si dhe u diskutuan pikëpamje të rëndësishme për përballimin e sfidave të reja dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi shumëpalësh për zgjidhjen e tyre.

Presidenti i Komitetit të Aviacionit, dr. Cioni në fjalën e tij theksoi se: “Mbrojtja dhe aftësitë parandaluese të NATO-s mbështeten

nga roli i aviacionit. Kjo kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, të përkushtuar dhe kolektive midis sferës ushtarake dhe civile, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Përveç kësaj, Komiteti i Aviacionit është forumi ku vendet anëtare, partnerë dhe organizatat ndërkombëtare ndërveprojnë në kuadër

të misionëve, operacioneve, stërvitjeve dhe trajnimeve të NATO-s”.

Në fjalën përshëndetëse shefi i Shtabit të Forcave Ajrore Italiane, gjenerali i Skuadrës Ajrore Luca Goretti, vlerësoi rëndësinë e madhe që ka ky takim duke theksuar se: “Në skenarin e paqëndrueshmërisë

dhe sfidave për vendet anëtare dhe partnerët e NATO-s, roli, detyrat dhe misionet e kryera nga Forcat Ajrore të Aleancës janë sot edhe më të domosdoshme dhe urgjente. Komponenti Ajror përfaqëson një nga aftësitë themelore të Aleancës”. Ai theksoi rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi midis NATO-s dhe Bashkimit Europian duke evidentuar se: “Bashkimi Europian miratoi Busullën Strategjike, dokumentin udhëzues të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së Bashkimit Europian. Në këtë kontekst, unë besoj se, si Autoritetet Ushtarake të NATO-s, ne duhet të ndjekim përfitimin e ndërsjellë përmes bashkëpunimit më të madh ndërmjet NATO-s dhe BE-së dhe shkëmbimi i ndërsjellë i praktikave më të mira”. Pjesëmarrësit në takim patën mundësinë për të vizituar Qendrën e Kontrollit të Zonës Civile-Ushtarake të Romës, ku ENAV (furnizuesi kryesor kombëtar civil i shërbimeve ATS) dhe kontrollorët e trafikut ajror të Forcave Ajrore punojnë së bashku dhe përdorimi i sigurt i hapësirës ajrore.

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Takimi vjetor i Forumit Ekonomik Botëror

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Davos: Liria është më e rëndësishme se tregtia e lirë



Në fjalimin kryesor në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, më 24 maj 2022, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se: “Liria është më e rëndësishme se tregtia e lirë dhe mbrojtja e vlerave tona është më e rëndësishme se fitimi”. “Një mësim i rëndësishëm nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës është se Perëndimi nuk duhet të tregtojë nevojat afatgjata të sigurisë për interesa ekonomike afatshkurtra”, -tha Stoltenberg. Ai theksoi se lufta tregon se si marrëdhëniet ekonomike me regjimet autoritare, si Rusia dhe Kina, mund të krijojnë dobësi, duke përfshirë energjinë. Sekretari i Përgjithshëm paralajmëroi gjithashtu për rreziqet e krijuara nga eksportimi i teknologjive të avancuara si Inteligenca Artificiale dhe kontrolli i huaj mbi infrastrukturën kritike, si 5G.

Stoltenberg e përshkroi luftën e Rusisë kundër Ukrainës si një “ndryshues të lojës” për rendin global, duke theksuar se roli i NATO-s është të shmangë përhapjen e konfliktit ndërsa vazhdon të ndihmojë Ukrainën të mbrohet. Ai e bëri të qartë se NATO do të mbronë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s, siç tregohet nga përforsime të mëdha për parandalimin dhe mbrojtjen kolektive të Aleancës, duke përfshirë 100 000 trupa tani në gatishmëri të lartë. Vendimi i Finlandës dhe Suedisë për të kërkuar anëtarësimin në NATO, nga ana tjetër, tregon se siguria europiane nuk do të diktohet nga dhuna dhe frikësimi, dhe se zgjerimi i NATO-s ka qenë një sukses historik dhe ka përhapur lirinë dhe demokracinë në të gjithë Europën.

Gjatë qëndrimit në Zvicër, Sekretari i Përgjithshëm u takua edhe me këshilltaren federale zvicerane Viola Amherd, shefe e Departamentit Federal të Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sportit, dhe e falënderoi ministrin për kontributin thelbësor të Zvicrës në misionin e NATO-s KFOR në Kosovë. Ai u takua gjithashtu me profesorin Klaus Schwab, themelues dhe kryetar ekzekutiv i Forumit Ekonomik Botëror.

Sekretari i Përgjithshëm më vonë mori pjesë në një panel të titulluar “Sigurimi i Europës” dhe përshkroi se si, në kontekstin e krizës në Ukrainë, NATO ka dy detyra: “të mbështesë Ukrainën por më pas në të njëjtën kohë të rrisë parandalimin dhe mbrojtjen që të mos përshkallëzohet konfliktit”. Atij iu bashkuan në këtë panel kryeministri i Belgjikës, Alexander de Croo, presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ministrja e Mbrojtjes e Holandës, Kajsa Ollongren, shefi i Administratës Presidenciale të Ukrainës Andriy Yermak dhe Francine Lacqua nga Televizioni Bloomberg.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen në Europë

Adresën e tij speciale në Takimin vjetor të Forumit Ekonomik Botëror, në Davos, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s e mbështeti në çështje thelbësore dhe tepër të rëndësishme për situatën globale. “Për gjysmë shekulli, Forumi Ekonomik Botëror ka bashkuar bashkësinë globale, për të shkëmbyer ide, njohuri dhe zgjidhje, për disa nga problemet më të rëndësishme dhe të vështira të botës. Sot na duhet edhe më shumë kjo frymë e Davosit. Lufta e presidentit Putin kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen në Europë. Është me të vërtetë një ndryshim i lojës, jo vetëm për sigurinë europiane, por për rendin global”, -tha në hyrje të fjalës

së tij Sekretari i Përgjithshëm. “NATO ka dy detyra themelore në përgjigje të agresionit të Rusisë, -tha ai, -që janë, ofrimi i mbështetjes për Ukrainën, por dhe duke parandaluar përshkallëzimin e luftës”. Për shumë vite, NATO dhe vendet e NATO-s kanë mbështetur Ukrainën, në veçanti Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, dhe gjithashtu Turqia”, -theksoi shefi i NATO-s, lidhur me sigurimin e pajisjeve dhe trajnimit për dhjetëra mijëra ushtarë ukrainas. “Ne shohim ndryshimin që po bën kjo çdo ditë në fushën e betejës. Që nga pushtimi i Rusisë, ne kemi rritur ndjeshëm mbështetjen tonë. Me miliarda dollarë armë dhe ndihma të tjera për të ndihmuar Ukrainën të ruajë të drejtën e saj për vetëmbrojtje, përfshirë në Kartën e OKB-së. Përgjegjësia kryesore e NATO-s është të mbrojtë të gjithë aleatët, por dhe të parandalojë që kjo luftë të përshkallëzohet, duke shkaktuar vdekje dhe shkatërrim edhe më të madh. Mund të jemi tronditur nga pushtimi brutal i Rusisë, por nuk duhet të habitemi. Ky pushtim ishte një nga aktet më të mira të parashikuara të agresionit ushtarak ndonjëherë. Në NATO, ne ndamë inteligjencën dhe ne e bëjmë publike inteligjencën për shumë muaj, për të paralajmëruar për planet e Putinit”, -kujtoi ai.

NATO, gati për t’iu përgjigjur çdo agresioni

“Sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës është pjesë e një modeli prej shumë vitesh, ku Moska përdor forcën ushtarake për të arritur qëllimet e saj politike. Shkatërrimi i Groznit, pushtimi i Gjeorgjisë, aneksimi i Krimesë, bombardimi i Aleppos dhe tani, lufta në Ukrainë. Që nga pushtimi i parë i Ukrainës në vitin 2014, NATO është përshtatur dhe përgatitur. Rritëm shpenzimet e mbrojtjes dhe investuam në kapacitete modern”, tha Stoltenberg duke shtuar se në përgjigje ndaj Rusisë NATO vendosi grupe luftarake në pjesën lindore të Aleancës, për herë të parë në historinë e saj. “Rritëm gatishmërinë e forcave tona dhe krijuam fusha të reja mbrojtëse, përfshirë hapësirën, dhe hapësirën kibernetike. Kur Rusia pushtoi Ukrainën përsëri këtë vit, NATO ishte gati. Ne dislokuam forca shtesë në lindje të Aleancës sonë. Sot, ne kemi mbi 40 000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s. Mbështetur nga mjete të rëndësishme ajrore dhe detare. Ne dyfishuam numrin e grupeve luf-

tarake shumëkombëshe, nga Baltiku në Detin e Zi dhe ne kemi 100 000 trupa në gatishmëri të lartë. Gati për t’iu përgjigjur çdo agresioni, për të mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s”, -tha Sekretari i Përgjithshëm. “Ky është frenim për të mos pasur vend për keqkuptime ose llogaritje të gabuara nga Moska. Për të mos provokuar konflikt, por për të parandaluar konfliktin dhe për të ruajtur paqen. Dhjetorin e kaluar, Presidenti Putin i paraqiti një ultimatum NATO-s. Ai kërkoi një traktat ligjërisht të detyrueshëm. Për të rishikuar arkitekturën e sigurisë në Europë, për të rivendosur sferat e ndikimit, për të detyruar NATO-n të tërhiqet nga pjesa lindore e Aleancës sonë dhe për t’i dhënë fund zgjerimit të NATO-s. Ai donte më pak NATO në kufijtë e tij dhe filloi një luftë. Tani ai po merr më shumë NATO në kufijtë e tij dhe më shumë anëtarë”, -theksoi Stoltenberg në fjalën e tij.

Vendimi i Finlandës dhe Suedisë për anëtarësim në NATO, rajoni i Detit Baltik dhe ekonomia

Vendimi i Finlandës dhe Suedisë për të aplikuar për anëtarësim në NATO është historik. Ai tregon se

siguria europiane nuk do të diktohet nga dhuna dhe frikësimi. “Të gjithë aleatët pajtohen se zgjerimi i NATO-s ka qenë një sukses i madh dhe përhapja e lirisë dhe demokracisë në të gjithë Europën. Kështu që unë kam besim se ne do të jemi në gjendje të gjejmë një mënyrë për të adresuar të gjitha shqetësimet e sigurisë të aleatëve, dhe të mirëpresim partnerët më të afërt të NATO-s në familjen tonë të kombeve të lira. Por ndërkohë, NATO është vigjilente në rajonin e Detit Baltik. Aleatët kanë rritur praninë e tyre, kemi shtuar stërvitjet dhe dislokimet dhe për herë të parë ndonjëherë, një grup i gatshëm amfib i SHBA-së është vendosur nën komandën e NATO-s. Anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë do të forconte gjithashtu lidhjen e ngushtë midis NATO-s dhe Bashkimit Europian. Siguria europiane dhe siguria transatlantike janë të ndërthurura thellë. Sot, rreth 600 milionë europianë jetojnë në një vend të NATO-s dhe 93 për qind e popullsisë së BE-së mbrohet nga NATO”, -tha Stoltenberg.

“Kordinimi gjithnjë e më i ngushtë midis NATO-s dhe Bashkimit Europian ka qenë kritik për trajtimin e krizës aktuale. Aleatët e NATO-s dhe Bashkimi Europian kanë vendosur sanksione të

paprecedentë ndaj makinës luftarake të Putinit. Vendet si Zvicra, Koreja e Jugut na janë bashkuar dhe kanë aplikuar gjithashtu sanksione dhe qindra kompani ndërkombëtare janë tërhequr nga Rusia. Këto sanksione masive na kujtojnë një nga mësimet e rëndësishme nga ky konflikt. Se ne nuk duhet të tregojmë nevojat afatgjata të sigurisë për interesa ekonomike afatshkurtra”, -nënvizoi Jens Stoltenberg.

Lufta në Ukrainë tregon se si marrëdhëniet ekonomike me regjimet autoritare mund të krijojnë

Dobësi, “mbështetja e tepërt në importin e mallrave kryesore, si energjia, rreziqet e krijuara nga eksportimi i teknologjive të avancuara, si inteligenca artificiale dhe elasticiteti i dobësuar i shkaktuar nga kontrolli i huaj mbi infrastrukturën kritike, si 5G. Bëhet fjalë për Rusinë por edhe për Kinën. Një tjetër regjim autoritar që nuk i ndan vlerat tona dhe kjo minon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla”.

“Tregtia ndërkombëtare ka sjellë padyshim një prosperitet të madh. Unë, dhe shumë prej nesh këtu sot, duke përfshirë Børge Brende, kemi punuar shumë për të promovuar një ekonomi më të globalizuar. Por ne duhet të pranojmë se zgjedhjet tona ekonomike kanë pasojë për sigurinë tonë.

Liria është më e rëndësishme se tregtia e lirë. Mbrojtja e vlerave tona është më e rëndësishme se fitimi. Në Samitin e NATO-s në Madrid muajin e ardhshëm, Udhëheqësit e NATO-s do të marrin vendime të guximshme. Të vazhdojmë të forcojmë dhe përshtatim Aleancën tonë. Për këtë botë më të rrezikshme dhe konkurruese. Konflikti në Ukrainë ka nënvizuar rëndësinë që Europa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku në NATO dhe për të punuar me partnerët tanë me mendje të njëjtë në mbarë botën. Për të mbrojtur vlerat tona dhe për të promovuar paqen dhe prosperitetin, në frymën e Davos-it, mbështetem edhe tek ju!”

DEXTER/ NATO demonstroi teknologji të re për të luftuar terrorizmin

Stacionet e metrosë, aeroportet dhe vendet e tjera të tranzitit dhe grumbullimit masiv në mbarë botën janë shënjestruar nga sulmet terroriste, duke çuar në humbje të jetëve dhe dëmtime të infrastrukturës. Me DEXTER, (Zbulimi i eksplozivëve dhe armëve të zjarrit për të luftuar terrorizmin), NATO ka zhvilluar prototipin e një teknologjie për të luftuar kërcënimin nga armët e zjarrit dhe eksplozivët në vende të mbushura me njerëz. Pas tre vitesh kërkimi të mbështetur nga Programi i NATO-s për Shkencën për Paqen dhe Sigurinë (SPS), një testim njëmuajor i prototipit u përfundua me sukses në një stacion metroje në Romë, Itali.

Më 24 dhe 25 maj 2022, përfaqësues nga industria dhe palët e interesuara të qeverisë u ftuan për të vëzhguar simulimin e skenarit të jetës reale dhe për të eksploruar mundësitë me synimin për komercializimin e mundshëm të DEXTER.

Tre teknologjitë e zhvilluara përmes DEXTER do të lejojnë identifikimin e transportuesve të armëve të zjarrit dhe eksplozivëve midis këmbësorëve në lëvizje, në distancë dhe në kohë reale. Sistemi do të lëvizë përtej masave të vendosura aktualisht dhe do të mundësojë zbulimin e këtyre kërcënimeve në mënyrë diskrete, pa kërkuar kontrolle të rastësishme për lëvizjen e pasagjerëve ose pikat e kontrollit. DEXTER integron teknologjitë në një aftësi që mund të inkorporojë sisteme zbulimi shtesë sipas nevojës për të vazhduar me kërcënimet në zhvillim. “Ajo që DEXTER ka ofruar është një zgjidhje në udhëkryqin midis kundër-terrorizmit dhe teknologjive të avancuara, në përputhje me objektivat dhe prioritetet strategjike të NATO-s”, -deklaroj Ndihamës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Sfidat e Sigurisë Emergjente, David van Weel. DEXTER është një rezultat i rëndësishëm i Planit të Veprimtë Kundër Terrorizmit të NATO-s. Në të njëjtën

kohë, duke u mbështetur në përparimet më të fundit në sensorë, zbulim dhe inteligjencë artificiale, DEXTER përfaqëson një shembull të përsosur të agjendës së NATO-s në fushën e Teknologjive në zhvillim dhe përçarjeje (EDT). “Rezultatet si ky nuk janë vetëm rezultat i aftësive shkencore dhe teknologjike, por bazohen gjithashtu në një ndjenjë të fortë kohezioni midis partnerëve dhe në vullnetin e përbashkët për të rritur mbrojtjen e qytetarëve nga sulmet brutale si ato në të kaluarën”, -deklaroj Gilberto Dialuce, President i ENEA-s, Agjencia Kombëtare Italiane për Teknologjitë e Reja, energjinë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik. Njëmbëdhjetë institucione qeveritare dhe kërkimore nga 4 vende të NATO-s (Franca, Gjermania, Italia dhe Holanda) dhe 4 vende partnere (Finlanda, Republika e Koresë, Serbia dhe Ukraina) morën pjesë në DEXTER.

Londër: "Defence Disrupted 2022"

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s hap konferencën e inovacionit dhe teknologjisë

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană hapi konferencën "Defence Disrupted 2022", më 26 maj 2022, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së avantazhit teknologjik të NATO-s dhe qëndrimit në ballë të inovacionit të mbrojtjes. Në një fjalim nëpërmjet videos drej-

tuar pjesëmarrësve të mbledhur në Londër, ai reflektoi se si inovacioni dhe teknologjia kanë qenë gjithmonë qendrore në misionin e NATO-s për të parandaluar luftën.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm paralajmëroi se sot, avantazhi teknologjik i Perëndimit po sfidohet



nga kombe që nuk ndajnë vlerat tona, si Rusia dhe Kina". Ai vuri në dukje investimin e Rusisë në raketat hipersonike, armët kibernetike dhe aftësitë e dezinformimit, dhe punën e Kinës për t'u bërë lider botëror në inteligjencën artificiale deri në fund të kësaj dekade. Megjithatë, ai vuri në dukje se: "Shoqëritë e lira dhe të hapura kanë një avantazh unik: faktin se mendjet tona më krijuese dhe novatore janë në gjen-dje të shprehën lirisht, të sfidojnë, të

mendojnë në drejtime të reja radikale, pa kërcënimin e hakmarrjes".

Duke nënvizuar rolin jetik të NATO-s si një platformë për bashkëpunim në teknologji dhe inovacion, z. Geoana vuri në dukje se ndërveprueshmëria është thelbësore për mbrojtjen kolektive të besueshme. "Dy anije mund të lundrojnë krah për krah, por nëse sistemet e tyre nuk mund të komunikojnë, nëse ato nuk mund të funksionojnë si pjesë e një tërësie më të madhe, ato mund të

jenë gjithashtu në oqeanë të ndryshme", -tha ai. Ai përshëndeti që Përsheptuesi i ri i Inovacionit të Mbrojtjes së NATO-s për Atlantikun e Veriut (DIANA) do të identifikojë dhe zhvillojë gjeneratën e ardhshme të teknologjive të reja, duke punuar me dhjetëra vende në Europë dhe Amerikën e Veriut. "DIANA, së bashku me një Fond të ri shumëkom-bësh të Inovacionit të NATO-s për sipërmarrjet fillestare që zhvillojnë teknologji moderne të përdorimit të dyfishtë, duhet të jenë plotësisht funksionale në vitin 2023", -tha z. Geoana.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm tha në fund të fjalës së tij se është jetike që kombet e hapura dhe demokratike të botës të punojnë së bashku për të siguruar që vlerat tona të mbeten në zemër të së ardhmes sonë teknologjike. Ai shtoi se: "Na takon të gjithëve në të luajmë rolin tonë në ruajtjen e sigurisë sonë dhe ndërtimin e një bote më të mirë dhe më të sigurt për brezat e ardhshëm".

NATO DHE BALLKANI PERËNDIMOR

Shefi i NATO-s pret në takim Presidentin e Bosnje-Hercegovinës, Sefik Džaferovic

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se dialogu politik dhe bashkëpunimi praktik me Bosnjën dhe Hercegovinën janë më të rëndësishme se kurrë, me luftën brutale të Rusisë në Ukrainë dhe ndikimin e saj malinj në të gjithë rajonin. Duke folur pas takimit me Kryetarin e Presidencës Treshe të Bosnje-Hercegovinës Sefik Džaferovic në selinë e NATO-s të mërkurën, më 25 maj 2022, z. Stoltenberg theksoi se NATO mbështet fuqimisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje-Hercegovinës dhe të përkushtuar ndaj mbetjeve të saj, aspiratat atlantike, për të mirën e të gjithë popullit të këtij vendi. Z. Stoltenberg tha se NATO do të bëjë edhe më shumë për të qëndruar me partnerët dhe se duke rritur mbështetjen politike dhe praktike, Bosnje-Hercegovina është një partner i çmuar për NATO-n. "Ne mbështesim fuqimisht sovranitetin dhe integritetin tuaj territorial. Qëndroni të përkushtuar ndaj aspiratave tuaja euroatlantike, për të mirën e të gjithë popullit tuaj. NATO është një mbështetëse e palëkundur e paqes dhe stabilitetit në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Dialogu ynë politik dhe bashkëpunimi praktik janë më të rëndësishëm se kurrë, me luftën brutale të Rusisë kundër Ukrainës dhe ndikimin e saj keqdashës në të gjithë rajonin. NATO do të bëjë edhe më shumë për të qëndruar me partnerët tanë", -tha Stoltenberg.

"Sapo kemi pasur një diskutim shumë konstruktiv se si mund ta thellojmë më tej bashkëpunimin tonë me Bosnje-Hercegovinën", -tha ai.

Gjatë takimit, Sekretari i Përgjithshëm diskutoi edhe rolin e NATO-s në Operacionin ALTHEA. Ai tha se bashkëpunimi i NATO-s me Bashkimin Europian për këtë mbetet thelbësor dhe se NATO do të vazhdojë të mbështesë këtë operacion të rëndësishëm të BE-së. Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e strukturave të unifikuara të Bosnje-Hercegovinës, duke përfshirë Forcat e Armatosura, një nga institucionet më të forta multi-etnike të vendit. Ai theksoi se këto institucione janë absolutisht jetike për stabilitetin e vendit dhe ato duhet të ruhen.

"I bëj thirrje të gjitha palëve që të ndalojnë retorikën përçarëse dhe të ndërmarrin hapa konkretë drejt pajtimit", -tha ai. Kryetari i Presidencës Treshe të Bosnje-Hercegovinës Sefik Džaferovic u takua edhe me Atlantikun e Veriut për shkëmbim mendimesh.



NATO respekton neutralitetin ushtarak të Serbisë Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s viziton Serbinë

Nga 23 deri më 25 maj 2022, Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s, gjeneralletënant Hans-Werner Wiermann ishte në Serbi, ku u takua me zyrtarë serbë, përfshirë ministrin e Mbrojtjes, Nebojsa Stefanović, sekretarin e Shtetit nga Ministria e Punëve të Jashtme, Nemanja Starović dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneralin Milan Mojsilović. Drejtori i Përgjithshëm u takua edhe me shefin e Zyrës së Ndërlidhjes Ushtarake të NATO-s, gjeneral brigade Antonello Zanitti.

Gjeneralletënant Wiermann e nisi programin e tij me një vizitë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Serbisë, ku u takua me gjeneralin Mojsilović. Diskutimet u fokusuan në situatën aktuale të sigurisë globale dhe rajonale, bashkëpunimin e deritanishëm NATO-Serbi dhe modalitetet e zgjerimit të mundshëm të tij.

Wiermann përgëzoi gjeneralin Mojsilović për shërbimin e Forcave të Armatosura Serbe dhe profesionalizmin e tyre dhe, për bashkëpunimin shembullor ndërmjet Autoriteteve Ushtarake Serbe dhe Komandantëve të Misionit KFOR të NATO-s. Në takimin me ministrin e Mbrojtjes, z. Nebojsa Stefanović, Drejtori i Përgjithshëm theksoi rolin që Serbia luan në rajon. "NATO ka respektuar gjithmonë neutralitetin ushtarak të Serbisë, duke njohur rolin stabilizues që ajo luan në rajon", -shtoi ai.

Më vonë, në takim me Sekretarin e Shtetit nga Ministria e Punëve të Jashtme, z. Nemanja Starović, Drejtori i Përgjithshëm komentoi partneritetin e qëndrueshëm ndërmjet NATO-s dhe Serbisë. "Gjatë 15 viteve të fundit, Serbia dhe NATO kanë krijuar një partneritet shumë konstruktiv. Jemi mirënjohës për komunikimin e hapur me Serbinë që na ndihmon të mbajmë të qëndrueshme situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor", -theksoi ai.

Gjeneralletënant Wiermann e përmbylli vizitën e tij me takimin me shefin e Zyrës Ndërlidhëse Ushtarake të NATO-s, gjeneral brigade Zanitti. E themeluar në dhjetor 2006, Zyra Ndërlidhëse luan një rol vendimtar midis NATO-s dhe autoriteteve serbe, veçanërisht në lehtësimin e bashkëpunimit serb me Aleancën në kuadër të Programit të Partneritetit për Paqe dhe mekanizmave të bashkëpunimit të vazhdueshëm ushtarak.

NISMA E ALEANCËS PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E ARDHSHËM (AFSC)

Luksemburgu forcon zhvillimin e ardhshëm të aftësive të mbikëqyrjes së NATO-s

Më 25 maj 2022, Luksemburgu deklaroi synimin e tij për të ofruar rreth 5 milionë euro midis 2023 dhe 2025 për të ndihmuar në përsheptimin e zhvillimit të aftësisë së parë të mbikëqyrjes me shumë fusha të NATO-s, e njohur si nisma e Aleancës për Mbrojtjen dhe Kontrollin e Ardhshëm (AFSC).

Një Letër Qëllimi u nënshkrua midis kolonelit Guy Hoffmann, Drejtori Kombëtar i Armatimeve të Luksemburgut, dhe Drejtores së Përgjithshme të NSPA, znj. Stacy Cummings, në selinë e NSPA në Luksemburg, më 25 maj 2022.

Nisma AFSC është përpjekja më e madhe dhe më komplekse e aftësive që NATO ka ndërmarrë deri më sot, aktualisht në Fazën e saj të Zhvillimit të Konceptit, e menaxhuar nga Agjencia e Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) dhe e financuar nga të 30 aleatët nën financimin e përbashkët të NATO-s. Aleanca po studion një sërë teknologjish në zhvillim dhe opsione të ndryshme si një aftësi përcjellëse për avionët AWACS, "sytë në qiell" të NATO-s, kur të dalin në



pension në vitin 2035. Kjo mund të përfshijë një përzjerje sistemesh në ajër, tokë, domenet detare, hapësinore dhe kibernetike. Karakteristikat kryesore të përbashkëta përfshijnë përdorimin e 'reve luftarake', arkitekturave të hapura, autonomisë, grupimit të drejtuar/pa pilot dhe aftësive komerciale të bazuara në hapësirë.

Në fillim të prillit 2022, NSPA dha tre kontrata të veçanta për Reduktimin e Rrezikut dhe Studimin e Fizibilitetit (RRFS) për tre ekiye të veçanta të industrisë: ekipin ABILITI të udhëhequr nga "Boeing", ekipin ASPAARO bashkë-drejtuar nga "Airbus Defense & Space" dhe "Northrup Grumman", dhe ekipi i udhëhequr nga "General Atomics Aeronautical Systems". Industritë kryesore të mbrojtjes do t'i ofrojnë Aleancës një pamje më të qartë mbi performancën dhe realizueshmërinë e koncepteve fillestare. Kjo do t'i lejojë aleatët të zgjedhin modelin përfundimtar për aftësinë e ardhshme të mbikëqyrjes dhe kontrollit dhe të marrin vendime për blerjet e ardhshme. Nisma AFSC është një përpjekje kolektive e të gjithë aleatëve të NATO-s. Kontributi dhe angazhimi aktiv nga aleatët individualë si Luksemburgu kanë qenë thelbësore për të avancuar projektin brenda afateve kohore dhe buxhetit të rënë dakord. Disa aleatë po kontribuojnë në nismën AFSC përmes studimeve kërkimore, ekspertëve të çështjeve dhe burimeve.

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Teknologjia, mani apo zhvillim

Teknologjia është një koncept i gjerë që merret me aplikimin e njohurive për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe përshtatjes së rrethanave në ambientin jetësor në përputhje me nevojat e tij.

Bota e sotme po ecën me hapa galopantë, por së bashku me zhvillimin teknologjik po shtohen edhe problemet që u vijnë njerëzve nga përdorimi i shumë të celularëve dhe internetit. Probleme shëndetësore, por edhe sjellje antishoqërore, këto janë disa nga pasojat negative të teknologjisë. Disa studime të fundit e kanë lidhur celularin me probleme të jetës së përditshme si shpërqendrimi, rreziku shëndetësor dhe probleme me gjumin.

Por a është vërtetë kaq i dëmshëm për shoqërinë dhe shëndetin celulari?

Një nga studimet e publikuara këtë javë ka zbuluar se nëse nuk e kemi celularin me vete ose pranë, kjo na bën më pak të përqendruar, rrit presionin e gjakut dhe na bën të ndihemi pa qejf. Varësia nga celularët është bërë një problem madhor, aq sa të qenit larg tyre na kufizon funksionet tona bazë dhe na bën të ndihemi jo mirë fizikisht, sipas shkencëtarëve. Ky ishte një ndër studimet e para që konstatoi se çfarë i ndodh njerëzve që janë të ndarë nga celularët dhe zbulimet nuk ishin aspak të favorshme për ne. Sipas përfundimeve, ne kemi performancë të ulët në detyrat mendore pa mjetin teknologjik që e kanë shumica e njerëzve në planet.

Teknologjia tek të rinjtë

Teknologjia, tashmë është një pjesë e pandarë e jetës sonë, e cila përdoret jashtëzakonisht shumë, sidomos nga të rinjtë. Megjithatë teknologjia është një fushë mahnitëse, një fushë e cila na habit me informacionet e larmishme të saj, nga të rinjtë po keqkuptohet dhe po keqpërdoret. Sot për shumë të rinj nuk ekzistojnë më ditarët, ku regjionin çdo gjë që ndodhte në jetën e tyre, sot nuk po u kushtohet vëmendja e duhur familjes apo miqve të ngushtë, gjithashtu edhe shumë gjëra të tjera të rëndësishme janë harruar, pasi çdo gjë, si momentet më të bukura, shqetësimet, problemet etj., i kalojnë nëpërmjet teknologjisë, pra nëpërmjet telefonave apo kompjuterëve, ku përdorim të gjerë kanë rrjetet sociale.

Si po ndikon teknologjia në jetën sociale?

Një studim i kryer nga disa psikologë ka zbuluar se teknologjia e sotme kthen një nga përdoruesit e vet në antishoqëror dhe narcizist. Në të gjithë botën, kërkuesit kanë zbuluar se rreth 182 milionë prej nesh janë të varur nga përdorimi i internetit. Teksa web-i bëhet gjithnjë e më i përhapur, është shfaqur nevoja për studime serioze mjekësore në lidhje me çrregullimet që vijnë prej internetit.

Fëmijët në grackën e teknologjisë

“Fëmijës i duhet dhënë ajo që i duhet, jo ajo që kërkon”, kjo është një shprehje e Sami Frashërit e cila zë vend në realitetin e sotëm ku fëmijët po bëhen gjithmonë e më shumë pjesë e ambientit virtual. Mënyra e jetës, por edhe ambienti jonë ka ndryshuar shumë në dhjetëvjeçarin e fundit. Është shtuar trafiku rrugor dhe dendësia e ndërtimit, duke bërë që aktiviteti fizik dhe mendor i fëmijëve të jetë pothuajse i vdekur. Zhvillimi i teknologjisë ka bërë që fëmijët të rriten në një ambient virtual duke marrë për bazë edukative

Varësia nga celularët është bërë një problem madhor, aq sa të qenit larg tyre na kufizon funksionet tona bazë dhe na bën të ndihemi jo mirë fizikisht, sipas shkencëtarëve. Ky ishte një ndër studimet e para që konstatoi se çfarë i ndodh njerëzve që janë të ndarë nga celularët dhe zbulimet nuk ishin aspak të favorshme për ne.

Teknologjia, mani apo zhvillim



të gjitha informacionet e pakontrolluara që i ofron teknologjia.

Interneti, televizioni, media

1. Televizioni nuk duhet të zëvendësojë nevojën e fëmijës për sport dhe lëvizje.
2. Televizori nuk ka vend në dhomën e fëmijëve.
3. Emisionet për fëmijë duhet të kufizohen dhe të kontrollohen nga prindërit.
4. Është shumë e rëndësishme që prindërit të diskutojnë me fëmijët e tyre rreth atyre që shohin në televizor.
5. Edhe emisionet parapërgatitore për shkollë mund të jenë ndonjëherë të dëmshme për fëmijë të një moshe të caktuar, pasi mbingarkojnë trurin e tyre të njomë me informacione të vështira për t'u kuptuar.

Deri në moshën 18 vjeç të rinjtë janë të dhënë pas atij që quhet konsum mediatik, duke qenë më tepër të ekspozuar ndaj televizorit dhe internetit. Por ajo që është kthyer në një fenomen dhe shqetësim për prindërit dhe specialistët janë video lojërat ose siç quhen ndryshe lojërat kompjuterike. Për këtë çështje ka disa qëndrime. Disa hulumtues mendojnë se video-lojërat ndikojnë në rritjen e inteligjencës dhe përmirësimin e notave të fëmijëve. Ndërsa të tjerë thonë se ato kanë një sërë pasojash negative, si një qëndrim të keq të trupit, probleme në komunikim në mjedisin e tyre, izolim social, obezitet, ekspozimi ndaj dhunës etj. Kjo problematikë është globale. Në shumë shtëpi por edhe në internet-kafetë shqiptare shoh fëmijë dhe të rinj që kalojnë kohën më të madhe duke luajtur lojëra kompjuterike.

Statistika sipas Fondacionit Kaiser Family (KFF)

Dy të tretat e foshnjave dhe të vegjëlvë shikojnë TV me një mesatare prej 2 orësh në ditë. Fëmijët nën moshën

gjashtë vjeçare shikojnë mesatarisht rreth 2 orë në ditë në ekran, kryesisht TV, video ose DVD.

Fëmijët dhe adoleshentët e moshës 8-18 vjeç shpenzojnë gati 4 orë në ditë para ekranit televiziv dhe gati 2 orë shtesë në kompjuter duke luajtur video-lojëra

Problematicat që hasin të rinjtë sot:

- Shkolla, lënia e mësimave pasdore
- Krijim konfliktesh (sherre)
- Pagjumësia
- Mos lexim i librave
- Lojërat-harxhim i kohës
- Vepra kriminale

Në shumë shkolla shqiptare po humbet pak e nga pak vëmendja e nxënësve ndaj mësimave dhe një nga shkaqet për këtë mbetet përqendrimi i tyre në rrjetet sociale. Sado të përpiqen mësuesit në shkolla për mos lejinim e përdorimit të telefonave në orën e mësimit, këta të rinj përsëri e gjejnë mënyrën për t'i përdorur ata.

Krijimi i konflikteve

Një burim mjaft i rëndësishëm i ekspozimit të shumë të rinjve në sherre të ndryshme mbetet “facebook- u”. Në shumë raste, shumë prej tyre përdorin fjalë ofenduese me njëri-tjetrin, duke përdorur mesazhet apo komentet dhe më pas e vijnë zënkën deri në përleshje, ku në rastin më të keq arrijnë deri aty sa mund të përdorin “armë të ftohta”.

Pagjumësia

Ora mund të shkojë 24:00, 01:00 apo edhe 04:00 dhe shohim se shumë të rinj qëndrojnë ende në rrjetet sociale. Por pse? A mund të ketë vallë punë shumë të rëndësishme një fëmijë 13-14 vjeçar, aq sa qëndron deri në orët e vona të natës?! Sigurisht që jo! Ky fiksim i të qëndruarit online deri në këto orë të vona shkakton probleme serioze

të shëndetit dhe gjithashtu sindromën e pagjumësisë e cila zhvillohet nga reduktimi i orëve të gjumit.

Braktisja e librave

Një gjë tjetër e keqe që mund t'i bësh librit përveçse ta grisësh, është mos-leximi i tij. Sot termi “libër” mbetet një term i harruar nga të rinjtë. Por sa gjë negative dhe e dëmshme mbetet kjo për shoqërinë tonë?

Lojërat elektronike, kohë e shkuar dëm

Fatkeqësisht sot shohim se shumë fëmijët e harxhojnë kohën duke luajtur lojëra të ndryshme si “counter-strike”, “vice-city” etj. Por sa gjëra të bukura mund të bënin ata gjatë kësaj kohe? Ata mund të lexonin, mësonin dhe mund të bënin shumë aktivitete sportive që do të ndihmonin në shëndetin e tyre, si atë fizik ose mendor.

Veprat kriminale

Nëpërmjet rrjeteve sociale ndodhin shumë vepra të ndryshme kriminale si vjedhje ose më keq, vrasje, dhe duhen marrë gjithmonë seriozisht. Nuk janë të pakta rastet kur vajza të vogla janë gënjyer me anë të rrjeteve sociale dhe kanë përfunduar në duar të prostitucionit ose abuzimit seksual.

Të përqafosh

zhvillimin teknologjik

Bota është gjithnjë në lëvizje, ndryshim dhe kërkim për përsosje të vazhdueshme. Jetojmë në erën e teknologjisë, e ardhmja i përket asaj. Njeriu synon përmirësimin e jetës së tij dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndryshimit. Të gjitha argumentet e mësipërme dëshmojnë se e ardhmja i takon teknologjisë. Nuk na mbetet gjë tjetër veç të ndjekim ritmin e ndryshimit, me kujdesin ndaj të miturve dhe vigjilencën për të panjohurën.

Teknologjia është shumë e rëndësishme dhe gati e pazëvendësueshme për njeriun modern, por ajo mbart

edhe efekte negative në jetën e njeriut dhe shoqërisë. Një ndër to është edhe ekspozimi i tepërt i fëmijëve 0-3 vjeç ndaj teknologjisë. Shpesh herë fëmijët shqiptarë që përdorin teknologjinë dëgjojnë video-animatorë në gjuhën angleze. Ka një pjesë të fëmijëve që i zhvillojnë të dyja gjuhët në mënyrë simultane dhe këtu jemi në rregull. Fëmijët që zhvillojnë dy gjuhë njëkohësisht kanë më tepër avantazhe se një fëmijë që përdor vetëm një gjuhë, por në këtë artikull do të merremi çrregullimin e dygjuhësisë. Duke qenë se ata jetojnë në një mjedis ku flitet shqip, kjo i bën ata të rrezikuar ndaj çrregullimit të bilingualizmit. Pra, fëmijëve që janë të ekspozuar në dy ose më shumë gjuhë mund t'u ndodhë konfuzioni bilingual ose multilingual dhe, për pasojë, këta fëmijë kanë vështirësi në zhvillimin gjuhësor në secilën gjuhë. Edhe në gjuhën shqipe ata hasin vështirësi, sepse duke qëndruar për një kohë të gjatë me teknologjinë, ata dëgjojnë në gjuhë të huaj e për rrjedhojë ajo nuk është më një e gjuhë e huaj për fëmijën, por ajo kthehet në një gjuhë familjare. Është një gjuhë e dytë, por kryesore për fëmijën. Sa më tepër të konsumojë kohë me gjuhën e huaj, aq më të mëdha janë gjasat që ai të zhvillojë atë gjuhë, e nga ana tjetër të ketë vështirësi në zhvillimin e gjuhës shqipe.

Por, mund të mos zhvillojë asnjërin e për rrjedhojë ai mund të mbyllet në vetvete prej pamundësisë së komunikimit, prej faktit se është mësuar të rrijë vetëm me teknologjinë që i është dhënë prej familjarëve të vet. Përmbajtje të medias mund të kontribuojë me shpejtësi të lartë në deficite të vëmendjes, si dhe zvogëlim të përqendrimit dhe kujtesës, për shkak të shkurtimit neuronal në korteksin frontal të trurit. Fëmijët të cilët nuk mund të kenë vëmendje nuk mund të mësojnë.

KOLONEL HYSNI GJERGJI
IKSHU

Ekspertët ushtarakë, pas 3 muajve “luftimi mësymës me tanke” të ushtrisë ruse, shtrojnë pyetjen nëse ka mbaruar epoka e tankeve të paktën në këtë lloj luftimi? Bazuar në evidencat e humbjeve, a është kjo luftë nekrologji për tankun si një instrument zjarri? A mbetet tanku kalorësia e shekullit të 21-të? Apo është një sistem mbështetës, si luftania në Luftën e Dytë Botërore? Apo është akoma, arma e zgjedhur për luftime tokësore mbrojtëse dhe mësymëse? A vazhdon tanku të ketë rol në zjarrin e fuqishëm në lëvizje, por me një koncept dhe doktrinë të rishikuar përdorimi? Nëse përgjigja është po apo ndoshta, atëherë hapi tjetër për industrinë e luftës do të jetë se si të mbrojmë tankun dhe si ta përsosim tankun dhe mjetet e tjera të blinduara, që t'i përshtaten fushës së luftimit dhe përballojnë armët kundërtank në lulëzim. Nisur nga ngjarjet në Ukrainë, kjo pyetje duhet trajtuar objektivisht dhe urgjentisht.

Në Ukrainë po vërtetohet rënia e mitit të fuqisë së mjeteve të blinduara, si të aftësive të tyre sulmuese me zjarr, ashtu edhe mbrojtjes së ushtarëve brenda kupolave të çeliktë. Bombardime me aviacion nga ajri dhe goditjet me tanke janë të ngjashme me luftën e II-të botërore në humbje të mëdha në njerëz. Humbje të mëdha janë shënuar edhe në personelin ekuipazh të tankeve, megjithëse kanë qenë nën mbrojtjen e “brumbujve metalikë të tokës”, si i quan Kadare.

Tanke ruse të shkatërruar në rrugët e Ukrainës, për të cilët ushtria ukrainase thotë se janë mbi 2000, ndërsa ajo ruse rreth 300, shikohen në çdo cep të Ukrainës nga ku autokolona ruse ka kaluar. Cilido të jetë numri i saktë i tankeve të shkatërruar dhe ushtarëve të vrarë brenda tyre, përsëri mbetet shumë i madh për 90 ditë luftë. Ushtria Ruse para 24 shkurtit, vlerësohej si ushtria e dytë më e mirë në botën moderne, ndërsa ushtria ukrainase ishte e nënvlerësuar, por që ka shfaqur aftësinë e saj luftarake fituese të bazuar vetëm në “shpirtin luftarak fitues dhe një grumbull armësh të dhuruara” nga vendet perëndimore, ndër kryesoret raketa supi të drejtuara kundërtank.

Gjeneralmajore Kathryn Toohey, nga Australia, në vitin 2019 i përcakton kështu tanket: “Tanket janë si shkatërat e darkës. Nuk ju duhen shumë shpesh, por kur nevojiten, asgjë tjetër nuk mund t'i zëvendësojë”. Gjeneralja shpjegon se tanku ka rezistuar dhe nuk është koha për funeralin e tij, përveç nëse provohet dështimi i tij në disa betejë. Është shumë herët për përfundime të tilla, por duhet të përpiqemi të kuptojmë pse mjetet e blinduara ruse janë paraqitur kaq të pambrojtura kryesisht, ndaj granatave kundërtank të supit.

“Tanku vdiq, jetë të gjatë Javelin”, -shkruan “The Telegraph”, më 23 prill, bazuar në statistikat e raportuara nga fronti i luftës në Ukrainë. Fakt është se tanket që deri dje përveç fuqisë së zjarrit, përcillnin supremaci edhe frikësim tek pala kundërshtarë. Sot në Ukrainë po kthehen në panik, pasi ekuipazhet ndjehen të tmerruar brenda “ferrit” të kupolave të çeliktë. Dizenjimi i tankut është një problem, pasi vendosja e municioneve për qark ekuipazhit dhe nën ndenjset e tyre, e bën shumë të rrezikuar jetën e tyre. Nëse tanku goditet, shpërthimi i predhave të tij në procesin zinxhir, e shumëfishon efektin shpërthyes.

Doktrina dhe koncepti i përdorimit të tankut i shoqëruar me këmbësori, kërkon që ai të jetë i mbrojtur nga zjarri i afërt, të cilët supozohet të shkatërrojnë minat

Në Ukrainë po vërtetohet rënia e mitit të fuqisë së mjeteve të blinduara, si të aftësive të tyre sulmuese me zjarr, ashtu edhe mbrojtjes së ushtarëve brenda kupolave të çeliktë. Bombardime me aviacion nga ajri dhe goditjet me tanke janë të ngjashme me luftën e II-të botërore në humbje të mëdha në njerëz.

Koncepti i përdorimit të tankut, drejt ndryshimit apo drejt dështimit



dhe pritë e ngritura nga forcat ukrainase. Nëse ushtria ruse do të ishte e aftë taktikisht, atëherë ATGM (raketat të drejtuara kundërtank) do të asgjësoheshin nga këmbësoria shoqëruese, mortajat ose mbështetja ajrore dhe kështu ekuipazhet ukrainase do të sprapseshin nga këmbësoria shoqëruese ruse, të paktën do të nxirrnin jashtë rreze së zjarrit ATGM deri në 2 km. Deri tani, këto taktika të luftimit mësymës me tanke mungojnë dhe ushtarët rusë po paguajnë çmim të lartë, për mungesën e doktrinës dhe konceptit të ri të përdorimit të tankeve në luftim mësymës.

Raketat e supit janë shumë të lira financiarisht dhe të përdorshme nga kushdo. ATGM-të janë kthyer në ferrin e mjeteve të blinduara ruse, duke ndryshuar ose vënë në pikëpyetje përdorimin e tyre. Kërcënimi kundërtank në Ukrainë është i ndryshëm nga ai i hasur në konfliktet e mëparshme, në aftësinë që raketat e supit mund të depërtojnë në armaturën e sipërme të tankeve. ATGM-të “Javelin”, të cilat i përkasin një gjeneratë të re, po rezultojnë shumë të suksesshme në luftën kundërt tankeve. Aq e vërtetë është kjo sa shtypi vendas dhe ndërkombëtar shkruan se të porsalindurve në Ukrainë, gjatë kësaj kohe iu vënë emrat e fëmijëve “Javelin” dhe “Javelinka”, si dhe duke e quajtur “shën Javelin”, në nderim të legjendës së krijuar për suksesin në luftën kundërt tankeve rusë. Ajo që duket e qartë në këto konflikte të këtij 10-vjeçari të fundit, është se një komb më pak i pasur mund të bëjë luftë të kombinuar me armë më të lira dhe jo shumë të sofistikuar. Nuk është më e nevojshme për një aftësi ushtarake jashtëzakonisht të trajnuar, të shtrenjtë, për të kryer një sulm lokal ajër-tokë ose ajër-ajër. Kjo vlen edhe për Shqipërinë, e cila me terrenin që ka, territorin e kufizuar dhe kufizimet financiare, ka nevojë për një mbrojtje ajrore dhe kundërtanke të mbështetur në dronë dhe raketa supi të drejtuara kundërt ajrore dhe kundërtanke. Pajisja e ushtrisë sonë me të tilla raketa siç deklaroi javën e kaluar ministri Peleshi, e modernizon dhe e përditëson mbrojtjen kundërtanke dhe është një hap drejt ndërtimit të kapaciteteve “smart”, pasi ul ndjeshëm shumë investime, si në buxhet ashtu edhe në personel. Ky kapacitet me raketa “Javelin” është i bazuar në teknologjinë më të re, të testuar jo vetëm në poligone, por edhe aktualisht në fushën e luftimit.

Përveç “Javelin” mes arsenalit të huazuar ukrainas, ka shumë ATGM të tjera, që janë kthyer në makt të mjeteve të blinduara ruse. Më e vjetra por e përmirësuar, është “Panzerfaust”, e cila ka bërë një paraqitje mbresëlënëse kundër kolonave të blinduara ruse. Çfarë përfaqëson kjo raketë kundërtank, e mbajtur mbi shpatullat një ushtari të vetëm, nga erdhi dhe pse po shkakton frikë tek ushtarët brenda tankeve të Vladimir Putinit? “Panzerfaust” u shpik në Luftën e Dytë Botërore në vitin 1943. Ishte koha kur BS krijoi tanke të klasit të parë që prodhoheshin me shumicë në seri. Si kundërvënje Gjermania zhvilloi një armë të vogël, të thjeshtë dhe të lehtë për t'u përdorur kundërt tankeve, e përshtatshme të kthente çdo njeri në një “vrasës” tankesh. I quajtur “Panzerfaust” (grushti i blinduar), është në thelb një tub që lëshon një granatë shpërthyes me një ngarkesë të aftë për të depërtuar blindën e tankut. Tubi i lëshimit mund të rimbushet nëse ka koka shtesë granatash, megjithëse është i lirë në kosto. Raketa u shpërnda në luftën e dytë botërore, si mes ushtarëve me përvojë ashtu dhe fëmijëve të trajnuar me nxitim të “Volkssturm” (stuhia popullore). “Panzerfaust” kërkonte guxim të jashtëzakonshëm për të vepruar në rrezen e tij efektive, pasi modellet e para ishin efektive deri në 70 metra. “Panzerfaust” ishte i aftë për të shpëtuar Rajhun nga kapitullimi, më 9 maj 1945, por u bë mjaft efektiv në ushtritë e pasluftës, duke bërë përmirësime në dizajn dhe në efektshmëri dhe në rrezen e zjarrit deri në 2,5 km.

Pas përdorimit në Afganistan nga ushtria gjermane, gjenerata e re e “Panzerfaust 3” po lufton përsëri kundërt tankeve ruse, por këtë radhë ushtarët që përdorin nuk janë gjermanë por ukrainas.

Fabrika e “Dynamit Nobel Allgemeine Gesellschaft”, ka punuar në versionin e fundit të raketës kundërtank nga viti 1978 deri në 1995, megjithëse u pranua nga Bundeswehr në 1992. “Panzerfaust 3” kushton 9 994 dollarë, ndërsa versioni IT-600 kushton 11 108 dollarë, për shkak të shënjestrës së tij të kompjuterizuar. Që nga viti 2003, janë prodhuar rreth 261 718 “Panzerfaust 3”. Në vitin 1989, Japonia u bë fuqia e parë e huaj që bleu këtë armë, e ndjekur nga Zvicra në 1991. Që atëherë, ajo ka hyrë gjithashtu në arsenalin e Austrisë, Italisë, Holandës, Perusë, Koresë së Jugut, Irakut dhe Mauritius. Ukraina e shtoi emrin e saj në listën e blerësve të kësaj arme kur forcat ruse e pushtuan atë në shkurt 2022. Në këtë kohë një sërë fuqish perëndimore dashamirëse filluan të furnizonin me armë, duke përfshirë “Panzerfaust 3”, për të forcuar mbrojtjen e Ukrainës. Deri më tani, ukrainasit i kanë përdorur ato në mënyrë shumë

efektive kundërt mjeteve të blinduara ruse duke shkatërruar tanke që kushtojnë disa miliona dollarë.

Një tjetër kërcënim për “konceptin e përdorimit të tankeve”, që kanë rezultuar të suksesshme në Ukrainë janë sistemet ajrore pa pilot. Fillimisht këta u krijuan gjatë “Luftës Globale kundërt Terrorit” pas vitit 2001, të njohur si robotë fluturues të drejtuar në mënyrë automatike të pavarur nga toka. Këta UAV (mjete fluturuese pa pilot) përdorin software dhe GPS (sistemin global të pozicionimit) për kontrollin, operimin dhe drejtimin e tyre të pavarur. “Predator-ët” dhe “Reaper-at” ishin të vlefshëm në grumbullimin e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit të teatrit të luftimit në terma afatgjatë, si dhe aftësinë e goditjes me saktësi me rreze të gjatë kundërt objektivave kritikë. Megjithatë, këta dronë (UAV) janë kompleks, të shtrenjtë dhe me infrastrukturë masive mbështetëse të nevojshme. Duke pasur parasysh kostot e tyre të larta dhe konkurrencën me sistemet e pilotuara nga njerëzit, ato nuk janë futur në një numër të madh në armatimin e ushtrive të botës. Ajo që ka tronditur sistemin kundërajror në mbrojtjen e tankeve kryesisht, është ardhja e dronëve më të vegjël dhe më të lirë, me “tufa” të frikshme dhe formacione me numër të madh.

Këta dronë të armatosur në fillim morën vëmendjen e publikut në luftën kundërt Shtetit Islamik të vetëshpallur ISIS. Ato që më parë konsideroheshin lodra të dyqaneve u shfaqën papritur në fushën e betejës të armatosur me granatë. Në dekadën e fundit, përhapja në rritje e sistemeve ajrore pa pilot në fushën e betejës ka qenë i frikshëm. Qofshin ata, goditës, zbulues, apo lodra të armatosura, sistemet ajrore pa pilot, ato janë një kapacitet luftarak me të cilën duhet të përballemi në të ardhmen.

Siç është vënë re edhe në Ukrainë, shumë sisteme ekzistuese të blinduara tokësore janë të cenueshme ndaj sulmeve nga lart-poshtë me dronë. Përdorime të tjera që kanë treguar efektivitet të dronit përfshijnë inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin; objektivat në marshim; mjetet e komunikimit etj. UAV-të janë të vështira për t'u kapur dhe nuk kërkojnë pilotë shumë të trajnuar për t'i drejtuar; i bën sistemet ajrore pa pilot efektive për shumë arsye: kosto, reduktim i rreziqeve për jetën e pilotëve në kabinë, kërkesa të ulëta të trajnimit, reduktimin e gabimeve njerëzore etj. Dronët dhe raketat do të zëvendësojnë efektivisht edhe artilerinë bregdetare për sa i përket mbrojtjes detare, pasi deri më tani nuk ka një kundër-armë efektive ndaj tyre.

Një artikull në “Foreign Policy” shpall se: “fuqia ajrore pa pilotë, ndryshon fushën e betejës të së ardhmes”, është analitik dhe bindës. Në këtë artikull, Scott Shaw, drejtori i Grupit i Luftës Asimetrike së Ushtrisë Amerikane, citohet duke vënë në dukje se në Nagorno-Karabakh: “Ju mund të shihni video të tankeve që goditen nga një sistem raketor i drejtuar supi dhe sistem ajror pa pilot; pozicionet e artilerisë që goditen nga një avion pa pilot; trupat që goditen nga një sistem ajror pa pilot etj.”. Ky nuk është vetëm alarmi i vdekjes për tankun, por ndoshta rilindje e një koncepti të ri të përdorimit dhe mbrojtjes së tyre.

Pyetja që shtrohet tek studiuesit ushtarakë, është se si një ushtri do të kryejë operacione të suksesshme luftarake tokësore, përballë kërcënimit të ri të paraqitur nga sistemet pa pilot që vjen nga ajri dhe raketat e supit nga toka. Mbrojtja e jetës së ushtarëve, nuk është e vetmja masë kryesore e suksesit në luftë, pasi edhe humbjet në logjistikë janë thelbësore për vazhdimin dhe mbështetjen financiare të konflikteve.

Qëndrimi kibernetik i Unionit: Këshilli miraton konkluzionet

Këshilli europian miratoi konkluzionet për zhvillimin e qëndrimit kibernetik të Unionit. Qëndrimi synon të demonstrojë vendosmërinë e BE-së për të dhënë përgjigje të menjëhershme dhe afatgjata ndaj aktorëve të kërcënimit që kërkojnë t'i mohojnë BE-së një akses të sigurt dhe të hapur në hapësirën kibernetike dhe të ndikojnë në interesat e saj strategjike, duke përfshirë sigurinë e partnerëve të saj.

Iniciativat për sigurinë kibernetike

Në konkluzionet, Këshilli nënvizon pesë funksionet e BE-së në fushën kibernetike:

1. Të forcojë elasticitetin dhe kapacitetet për të mbrojtur
2. Rritjen e solidaritetit dhe menaxhimit gjithëpërfshirës të krizës
3. Promovimi i vizionit të BE-së për hapësirën kibernetike
4. Rritja e bashkëpunimit me vendet partnere dhe organizatat ndërkombëtare
5. Parandalimi, mbrojtja dhe reagimi ndaj sulmeve kibernetike

Ministrat, ndër të tjera, i bëjnë thirrje Komisionit të propozojë kërkesat e përbashkëta të BE-së për sigurinë kibernetike për pajisjet e lidhura dhe proceset dhe shërbimet shoqëruese, fton autoritetet përkatëse si Agjencia e BE-së për Sigurinë Kibernetike (ENISA) të formulojnë rekomandime për të përforcuar qëndrueshmërinë e rrjeteve të komunikimit dhe infrastrukturës brenda BE-së dhe thekson rëndësinë e krijimit të ushtrimeve të rregullta kibernetike për të testuar dhe zhvilluar reagimin e brendshëm dhe të jashtëm të BE-së ndaj incidenteve kibernetike në shkallë të gjerë.

Hapësira kibernetike është bërë një arenë për konkurrencën gjeopolitike dhe për këtë arsye BE-ja duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet me shpejtësi dhe me forcë sulmeve kibernetike, të tilla si aktivitetet kibernetike keqdashëse të sponsorizuara nga shteti që synojnë BE-në dhe shtetet e saj anëtare dhe të përdorë plotësisht të gjitha instrumentet e saj. Aktorët armiqësorë duhet të jenë të vetëdijshëm se sulmet kibernetike kundër Shteteve Anëtare dhe institucioneve të BE-së do të zbulohen herët, do të identifikohen menjëherë dhe do të përmbushen me të gjitha mjetet dhe politikat e nevojshme.

NGA KOLANA E LIBRIT "OFICERET SHQIPTARE NË RRJEDHËN E HISTORISË"

Albana Strori, oficerja shqiptare që u përgatit në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" të Anglisë

Albana Strori ka lindur në vitin 1986. Pas përfundimit me sukses të arsimit tetëvjeçar dhe të mesëm, gjithmonë ishte në realizim të një dëshirë, të bëhej oficer, në vazhdim dhe të traditës së saj familjare. Kjo mundësi i lehtësohet në vitin akademik 2004-2005, i cili do të shënonte një risi në jetën akademike të universiteteve shqiptare. Do formohej krahas universiteteve të tjera, Universiteti Ushtarak "Skënderbej" me VKM nr. 720, datë 30.10.2003, "Për krijimin e Universitetit Ushtarak "Skënderbej". Këtij grupi i përket edhe oficerja Albana Strori. Kështu, në përfundim të studimeve të shkollës së mesme në qytetin e saj të lindjes, midis zgjedhjeve të shumta që i ofroreshin ajo zgjodhi pikërisht Universitetin Ushtarak. Albana bënë pjesë në atë grup të rejash që këtë zgjedhje për profesionin e saj të ardhshëm e ka bërë që prej fillesave jo vetëm me bindje, por edhe me pasion. Vajzë e dy prindërve mësues, e rritur në vitet kur ushtria pak nga pak kishte filluar të mos kishte atë shkëlqimin e dikurshëm, nuk hezitoi pasi në mendjen e saj e kishte projektuar qartë të ardhmen. Ditët e para në mjediset e universitetit ia shtuan këtë bindje. U dashurua me uniformën dhe kjo ishte sfida e parë me jetën që e priste. Por të ndjekësh një universitet ushtarak, punës akademike i shtohet edhe stërvitja e përgatitja fizike. Aq sa prindërit e saj, tek e shihnin vajzën e tyre të brishtë të ngarkuar me pajime, mendonin se ajo nuk do ta mbyllte as semestrin e parë të vitit shkollor. Por Albana jo vetëm e mbylli, por në vitin 2008 pasi kishte përfunduar shkollën dhe kishte nisur punën si nëntogere dhe komandante toge vendosi edhe një herë ta sfidonte "fatin". Në kursin e trajnimit 6-mujor për oficerët e fillestarët ajo zgjodhi të ndjekë specialitetin e këmbësorisë, një specialitet ky ku zakonisht janë meshkujt ata që bëjnë "komandën". Por vitet e shkollës e kishin bërë të kuptonte se në ushtri "nuk mund të mbijetosh" e aq më pak të mund të marrësh kënaqësinë e profesionit, nëse nuk e vë veten në provë. Të guxosh për të realizuar ëndrrën. Karriera e saj nis nga roli bazë...

...Në moshën 22-vjeçare, me gradën "nëntogere", u emërua komandante e Togës Mbështetëse në Ndërlidhjen e Tufinës. Në stërvitjen e parë, ishte në Bunavi të Vlorës, e rreshtuar në krah të 115 meshkujve. Në fakt, nuk ishte femra e vetme, pasi kishte edhe 20 kolege. Kjo ishte sprovë e parë, pasi e dyta, në Zall Herr, nuk do t'i shqitet sa të jetë gjallë nga mendja. Ishin 6 javë të vështira. "E kam parë veten keq në Zall Herr, në vitin e dytë të studimeve në Akademi, kur për 6 javë ndoqëm një kurs intensiv fizik, të quajtur "Luftëtari i çeliktë", nën kujdesin e oficerëve amerikanë. Në numrin e parë stërvitor, kishim hedhjen 45 metra me litarë nga kulla, më pas marshim për 12 orë në shi e në diell, me çantën në kurriz, pa e lëshuar për asnjë çast. Por ia dolëm mbanë, po aq mirë sa edhe kolegët e tjerë meshkuj, madje duke treguar në aspektin fizik përgatitje më të lartë edhe se vetë ata..." - kujton Albana.

Por një arritje e rëndësishme në karrierën e saj, është e drejta e studimeve njëvjeçare në Akademinë Ushtarake Mbretërore "Sandhurst" të Anglisë. Këto studime ajo i nisi në shtator të vitit 2013 dhe i përfundoi (u diplomua) në dhjetor të vitit 2014. Akademia Ushtarake Mbretërore e "Sandhurst" (RMAS) është sot një ndër shkollat ushtarake më me prestigj në botë. Kjo akademi ka si moto "të qenurit një qendër kombëtare e ekselencës për leadership". Pikërisht ky motivim ka bërë që nëpër vite pjesëtarë të saj të jenë jo vetëm ushtarakë të Britanisë së Madhe, por edhe kadetë jashtë saj. Në historikun gati 200-vjeçar të kësaj Akademie Mbretërore, janë të shumtë emrat e njohur të së shkuarës e së sotme, që kanë lënë gjurmë një jetën politike e ushtarake. Padyshim një numër i madh emrash vijnë nga përfaqësuesit e oborreve mbretërore të Europës, por jo vetëm,



Captain Albana
STRORI
|
Strategic
Planning &
Modernization
Specialist
|
Albanian Armed
Forces

sepse janë jo të pakët përfaqësuesit e familjeve mbretërore të vendeve Arabe që kanë ndjekur trajnimin në "Sandhurst". Kështu nga familja mbretërore dy përfaqësuesit më të rinj të saj princi Uilliam, Duka i Kembrixhit dhe princi Herri kanë ndjekur shkollimin ushtarak në "Sandhurst". Po kështu një ndër figurat më karizmatike të politikës angleze sir Uinston Çerçill gjithashtu ia dedikon formimin e tij ushtarak kësaj akademie. Emra të tjerë të njohur si mbreti Hysein i Jordanisë apo sultani i Bruneit Hassanal Bolkiah, Sheik Saad Al Abdullah Al Salim Al Sabah, Emir i Kuvajtit janë gjithashtu pjesë e listës së gjatë me emra të figurave të shquara që janë diplomuar në "Sandhursts". Në këtë histori suksesi edhe familja mbretërore shqiptare ka pasur dy përfaqësues të saj studentë në "Sandhurst". Leka Zogun dhe princ Lekën në vitin 2006, diplomuar si "Studenti më i mirë i huaj i Akademisë".

...Studimet në këtë akademi, ishin një fat dhe suksesi që vjen nëpërmjet vështirësive e sakrificave të shumta për oficeren e re Albana Strori. Në Ministrinë e Mbrojtjes vazhdimisht janë ofruar trajnime për FA-të, por të mund të mbërrish deri te fitimi i një burse në një shkollë ushtarake prestigjioze si Akademia Ushtarake Mbretërore Sandhurst, për një vajzë që sapo ka filluar karrierën është më shumë se një ëndërr. Mes fitimit dhe realizimit të suksesshëm të misionit rruga është e gjatë dhe e vështirë. Gara e shpallur nga Ministria e Mbrojtjes dhe atashu ushtarak britanik në Shqipëri nxit dëshirën e një grupi oficerësh të rinj për t'u trajnuar në një akademi si "Sandhurst". Pas një sërë testimesh fizike si dhe testimi mbi njohuritë ushtarake, atashu ushtarak anglez përzgjedhi për herë të parë dy oficerë të reja që do t'i bashkoheshin historikut të lavdishëm të "Sandhurst-it". Njëra prej tyre ishte Albana Strori. Padyshim edhe zgjedhja e bërë nuk ishte rastësore pasi djemtë e talentuar nuk mungonin, por në kuadër të krijimit të një

fryme të re mbi rolin e femrave në FA, duket se "barazia gjinore" favorizoi me meritë femrat. Te vajzat oficerë ai vlerësoi më së pari, këmbënguljen e tyre për të garuar me të njëjtën forcë si edhe kolegët e tyre, qëndresën dhe përballimin me sukses të të gjitha testeve fizike, ku barazia gjinore nuk hynte në "lojë". Por a kishte bërë zgjedhjen e tyre komisioni i vlerësimit? A do ta përballonte Albana trajnimin ushtarak që e priste? Kjo ngelej për t'u parë kur të përballej me atë çfarë e priste në të ardhmen. Në "Sandhurst", ku trajnohen edhe princërit, në jugperëndim të Londrës, rreth 55 km larg saj shtrihet "Sandhurst". Teksa niste kursin përgatitor në shtatorin e vitit 2013, Albana e gjeti veten mes një grupi multietnik. Nga Ballkani kishte vetëm një kolege nga Bosnja dhe pjesa më e madhe e oficerëve që ndiqnin kursin e trajnimit vinin nga vendet arabe apo vendet afrikane. Bile, në radhët e tyre gjendeshin princër e kandidatë për mbretër. Por rregulli i akademisë ishte një për të gjithë, andaj kush nuk përmbushte kërkesat e stërvitjes apo të disiplinës ishte i detyruar ta ndërpriste atë. Akademia Ushtarake Mbretërore njihet për shkallën e lartë të vështirësisë së stërvitjes fizike. Me jetën ushtarake oficerja shqiptare nuk e pati të vështirë të përshtatej pasi ajo vinte pikërisht nga një jetë e tillë, por përballja me një grup multikulturor sigurisht kërkonte më së pari mirëkuptim... Stërvitjet e zhvilluara ishin të ngjashme me ato të një situatë lufte. Zakonisht zgjasnin 1-2 javë, me një ngarkesë pajimesh rreth 50 kg, në kushtet e një terreni të vështirë. Si një qendër ushtarake trajnimi që formëonte liderë, edhe detyrat që jepeshin synonin të evidentonin këto cilësi. Në shkurt akademia organizoi një marshim prej 50 km në kodrat e Uellsit, të mbuluara nga dëbora. Në këtë marshim kadetët ndaheshin në skuadra prej 10 vetash. Terreni ishte plotësisht i panjohur për ta. Dhe këto 50 km me 15 kg pajime, duhet të përshkoheshin

brenda 24 orëve. Vetëm guximi, por edhe qëndresa bënë që Albana t'ia dilte, por jo e vetme por së bashku me togën që drejtonte. Dhe kjo nuk ishte e vetmja stërvitje e vështirë. Ky ishte vetëm fillimi. Net të tëra të qëndrimit në transhe, por jo në një mot të zakonshëm, ku edhe mund ta shtyje natën duke parë yjet. Por nën qiellin tipik londinez, që qëmtonte atë shiun e tij të hollë, por të dendur. Kur Albanës nuk i duhej të mendonte vetëm për veten (për ditë të tëra për gati një muaj, marshoi me këmbën e dëmtuar pa e ditur askush), por si komandante toge, duhej të mendonte për togën. Dështimi i çdonjërit prej tyre, do të quhej edhe dështimi i saj. Pikërisht këto cilësi të sajat evidentoi komandanti i shkollës duke e dalluar oficeren shqiptare, në fjalën e tij përshëndetëse në përfundim të akademisë njëvjeçare. Diplomimi është një ditë arritje për çdo individ, por sigurisht diplomimi i ushtarakëve duket se edhe për vetë mënyrën se si organizohet mbart mbresa të veçanta. Për Albanën kjo ditë u bë dyfish e gëzuar, pasi në krah pati jo vetëm prindërit, motrën, por edhe përfaqësuesin më të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes së vendit të saj.

Krenaria ishte e pa matë. Emocionet gjithashtu. Kishte mbyllur me sukses një cikël, kishte lënë gjurmën e saj në "Sandhurst" dhe po largohej me shumë dëshirë që dijen që mori aty të mos e mbante për vete, por ta vinte në shërbim të atdheut. E përgatitur si lider për situata të njëjta me ato të luftës, ajo e sheh veten pjesë të misioneve paqeruajtëse që vendi ynë dërgon në rajon e më gjerë si pjesë e NATO-s. Ajo është gati edhe për këtë sfidë të radhës. Të jesh ushtarak do të thotë të guxosh dhe të veprosh. Sot është një ushtarak e formuar, e aftë për të përballuar me sukses çdo detyrë që i jepet, pavarësisht shkallës së vështirësisë.

Riza Rada u lind më 6 mars 1924 në fshatin Steblevë të Dibrës, në një familje të madhe, si djali i dytë, pas vëllait që e kishte 16 vjet më të madh se vetja në moshë, në familjen e Radajve, e përbërë nga pesë xhaxhallarë, si pjesë e një fisi të vjetër, një nga 16 fiset më të vjetra në këtë fshat, që figuron edhe në regjistrin e parë të bërë në trojet shqiptare nga Perandoria Osmane në vitin 1467 të shekullit të XV-të.



RIZA KURT RADA, PARTIZANI NGA STEBLEVA QË LUFTOI NË MITROVICË

Të shumtët e njohin si njeriu i thjeshtë që nuk i ndau kurrë librat nga dora, por për Riza Radën ka shumë më tepër. U lind më 6 mars 1924 në fshatin Steblevë të Dibrës, në një familje të madhe, si djali i dytë, pas vëllait që e kishte 16 vjet më të madh se vetja në moshë, në familjen e Radajve, e përbërë nga pesë xhaxhallarë, si pjesë e një fisi të vjetër, një nga 16 fiset më të vjetra në këtë fshat, që figuron edhe në regjistrin e parë të bërë në trojet shqiptare nga Perandoria Osmane në vitin 1467 të shekullit të XV-të.

Ashtu si shumica e familjeve steblevase edhe fisi Rada e kishte organizuar jetën midis jetës së fshatit dhe tregtisë në qytetet kryesore të vendit, sepse siç dihet ADN-ja e Steblevës është zanati i tregtarit, dikur me karvanë dhe sot me dyqane dhe magazina moderne.

Kreu shkollën fillore në vendlindje, me mësuesin e shquar, me kulturë perëndimore të diplomuar në Austri, Vahit Kormakun (bashkëpunëtorin e Prof. Aleks Budës), ku Rizai do të ishte një ndër nxënësit më të dalluar në mësime. Nga kjo shkollë, nga ky mësues dhe nga kjo moshë, Rizait, do t'i lindte dëshira për të lexuar pafundësisht libra në gjuhën shqipe.

Më vonë do të qëndronte më shumë në qytetet Elbasan dhe Durrës, ku vëllezërit Rada kishin hapur dyqanet tregtare të shërbimit si restorante dhe ëmbëltore, mbështetur edhe nga blegtorja që kishin duke e mbajtur në verë në Steblevë dhe në dimër në zonat e ulëta si Kavajë e Durrës.

Pushtimi fashist, më 7 prill 1939, do ta gjente në qytetin e Durrësit duke ndihmuar në punët e tregtisë. Në fillim të vitit 1941 i vdes nëna, kur ishte në moshën 17 vjeçare, por vazhdon të jetojë dhe punojë në Durrës dhe në Kavajë, ku pjesa tjetër e familjes merrej me blegtori dhe furnizonte dyqanet në Elbasan dhe Durrës.

Në fillim të vitit 1942 vihet në kontakt me grupet antifashiste në qytet dhe merr pjesë edhe ai si një i ri me ideale për të luftuar fashizmin. Më pas në vitin 1943 lidhet me grupin e Pezës që vepronte në Durrës, me Skënder Pezën, vëllain e Myslim Pezës dhe në vitin 1944 inkuadrohet me forcat partizane të Batalionit të I të Brigadës së XXII. Edhe vëllai i tij Hyseni ishte inkuadruar në radhët e Brigadës së I Sulmuese.

Brigada XXII do të vazhdonte luftimet me Divizionet partizane në ish-Jugosllavi. 29 nëntori 1944 do ta gjente Rizain duke luftuar në Koplik të Shkodrës, ndërsa një ditë më parë, më 28 nëntor, ushtria



RIZA RADA

Në fillim të vitit 1942 vihet në kontakt me grupet antifashiste në qytet dhe merr pjesë

edhe ai si një i ri me ideale për të luftuar fashizmin. Më pas në vitin 1943 lidhet me

grupin e Pezës që vepronte në Durrës, me Skënder Pezën, vëllain e Myslim Pezës dhe

në vitin 1944 inkuadrohet me forcat partizane të Batalionit të I të Brigadës së XXII. Edhe

vëllai i tij Hyseni ishte inkuadruar në radhët e Brigadës së I Sulmuese.

partizane kishte parakaluar si fitimtare në Tiranë.

Nga luftimet në ish-Jugosllavi, në Kosovë, nuk do ta harronte deri në fund të jetës rrethimin nga gjermanët e kompanisë së dytë, ku bënte pjesë sepse në këtë luftim kompania e tij do të dëmtohej shumë, do të kishte shumë të rënë dhe të plagosur, ndër to, Rizai dhe Bajrami nga Dibra dhe një shok nga Tepelena. Lidhjet e tyre u mbajtën deri në fund të jetës së tyre.

Pas qëndrimit për tre javë në spitalin e Mitrovicës, në Kosovë, Rizai dhe partizanët e plagosur kthehen në Shqipëri

në maj të vitit 1945.

Pas kthimit nga lufta ai qëndron për tre vjet në fshat, martohet me Emine Kuburin, po nga Stebleva dhe pas lindjes së djalit të parë, vendoset në Tiranë si me banim ashtu edhe me punë.

Bashkë me shumë bashkëfshatarë të tjerë punuan për disa vite për ndërtimin e kombinatit të tekstileve.

Për arsye familjare dhe shëndetësore, në fund të vitit 1955 do të rikthehet përsëri në Steblevë, duke lënë shtëpinë në Tiranë, me mendimin për t'u rikthyer përsëri në kryeqytet, por rrethanat rrodhën në drejtim tjetër dhe

në Tiranë do të rikthehej vetëm pas vitit 1991, për të banuar pranë djalit të madh deri në fund të jetës.

E veçanta e tij ka qenë fakti se ai asnjëherë nuk e ka ndarë leximin e librave dhe gazetave, duke qenë gjatë gjithë jetës së tij një punëtor i ndershëm dhe një prind shembullor që rriti dhe edukoi edhe tre fëmijët e tij me ndjenjën e punës dhe virtytin e ndershmërisë, duke mos bërë kompromis me padrejtësinë. Atë që kishte ta përplaste në sy, kushdo qofsh, gjë që nuk do t'i pëlqente pushtetit të asaj kohe, por që e bënte të gëzonte respektin e të gjithëve. Ishte

i kudo ndodhur në çaste gëzimesh e hidhërimesh të shokëve e bashkëfshatarëve.

Duke qenë i drejtë dhe i sinqertë me shumë se çdokush, tregon djali i tij, Qemali, nuk do t'i shpëtonte edhe një "përplasje" në dhjetorin e vitit 1967 me kryeministrin e asaj kohe Mehmet Shehun, i cili po kalonte nëpër Steblevë për të parë gjendjen dhe pasojat e tërmetit që goditi rrethet Librazhd dhe Dibër.

Edhe në fshatin Steblevë nga ky tërmet do të kishte shumë dëme materiale dhe midis shtëpive të shkatërruara do të ishte edhe shtëpia e madhe dykatëshe e fisit Rada.

Në takimin e organizuar me rastin e vizitës së kryeministrit Mehmet Shehu në vendin e mbuluar nga bora, Rizai i drejtohet kryeministrit duke i thënë se ndihmat që po vinë për të eliminuar pasojat e tërmetit janë të pakta, dhe ato që vijnë i marrin pushtetarët dhe të fortët, duke mos pasur drejtësi në shpërndarje për familjet më të dëmtuara.

Pushtetarëve vendorë dhe atyre të rrethit, që e shoqëronin kryeministrin nuk u erdhi aspak mirë ngritja e këtij shqetësimi.

Mehmet Shehu i përgjigjet se kërraba tërheq nga vetja dhe drejtohet nga vetura për t'u larguar, por Rizai i del përpara dhe i prezantohet me emër: Riza Rada, partizan i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare: "Shoku kryeministër, kur dolëm në luftë nuk luftuam për padrejtësinë, por për drejtësi popullore. Mehmet Shehu hesht, futet në veturë dhe ikën.

Për këtë reagim të bërë publikisht nuk do të shikohej mirë nga pushteti vendor që drejtonte në atë kohë fshatin dhe lokalitetin, por nuk kishin se çfarë t'i bënin se ai ishte njeri i punës dhe vazhdoi të jetë punëtor në Ndërmarrjen e shfrytëzimit të drurit ose të Sharrave siç quhej atëherë. Më vonë punon në kooperativë deri në daljen në pension në vitin 1984, pension pune plus shpërblimin e veteranit të luftës.

U largua nga kjo botë në vitin 2000 pasi jetoj në tre sisteme të ndryshme shoqërore, me luftë dhe sakrificë si të gjithë, i plotësuar familjarisht me fëmijët, nipër e mbesa duke u bërë edhe stërgjysh, por do të mbahet mend gjithmonë si njeri i drejtë dhe i dashur me të gjithë.

Përgatiti:
SAKIP CAMI

Teknologjitë e reja përdoren në të gjitha fushat e jetës njerëzore, dhe ushtria sigurisht nuk është lënë jashtë saj. Armët moderne si tanket dhe nëndetëset janë zhvilluar të gjitha, por çfarë mund të përdorë një ushtar për mbrojtjen e tij/saj personale? Këto janë sigurisht uniformat e tyre. Kështu që sot ne do të shohim disa uniforma ushtarake më të fuqishme në mbarë botën, disa nga këto armë janë ende në zhvillim, dhe shumica janë tashmë të zhvilluara.

Uniforma ushtarake është një veshje e standardizuar e veshur nga anëtarët e forcave të armatosura dhe paraushtarakët e kombeve të ndryshme.

Veshjet dhe stilet ushtarake kanë kaluar nëpër ndryshime të rëndësishme gjatë shekujve, nga veshjet shumëngjyrëshe dhe të përpunuara, të zbkuruara deri në shekullin e 19-të, tek uniformat e kamuflazhit utilitar për qëllime fushore dhe beteje nga Lufta e Parë Botërore (1914–1918) e në vazhdim. Uniformat ushtarake në formën e veshjes së standardizuar dhe të veçantë, të destinuara për identifikim dhe ekspozim, janë zakonisht një shenjë e forcave të organizuara ushtarake të pajisura nga një autoritet qendror.

Por cilat janë uniformat më mbresëlënëse në botë?

1. Luftëtari i Forcës së Ardhshme (Future Force Warrior-FFW)

Ky projekt po kryhet nga departamenti ushtarak i Shteteve të Bashkuara,



ture Force Warrior janë të përmbushin sa vijon duke përdorur një paradigme të projektimit humancentrik:

- Siguron aftësi bashkëpunuese të shpërndara nëpër njësinë e vogël luftarake.
- Zvogëlon peshën e luftëtarit individual dhe të njësisë së vogël luftarake.
- Përforon dhe zgjeron aftësinë për të parë dhe dëgjuar fillimisht.
- Ju bën të mundur të njihni shpejt, kuptoni, vendosni dhe rregulloni në lëvizje.
- Shumëzon aftësinë për të qenë jashtëzakonisht vdekjeprurës.
- Zgjeron aftësinë për të mbijetuar dhe duruar misionin më të gjatë.
- Optimizon konceptin e operacioneve për njësinë e vogël luftarake - Ndryshon mënyrën e luftimit.

2. Ratnik 3

“Ratnik Three” është konkurenti më i afërt me FFW, uniforma është krijuar për të mbrojtur ushtarët nga armët e rënda. “Ratnik Three” nuk merret



Veshjet dhe stilet ushtarake kanë kaluar nëpër ndryshime të rëndësishme gjatë shekujve, nga veshjet shumëngjyrëshe dhe të përpunuara, të zbkuruara deri në shekullin e 19-të, tek uniformat e kamuflazhit utilitar për qëllime fushore dhe beteje nga Lufta e Parë Botërore (1914–1918) e në vazhdim. Uniformat ushtarake në formën e veshjes së standardizuar dhe të veçantë, të destinuara për identifikim dhe ekspozim, janë zakonisht një shenjë e forcave të organizuara ushtarake të pajisura nga një autoritet qendror.

Uniformat ushtarake më të frikshme e mbresëlënëse në botë



me fleksibilitetin, kështu që kostumi i betejës është bërë me titan në vend të materialeve të reja të lehta në FFW. Kornizat e ngjashme me ekzoskeletin mundësohen nga një bateri elektrike që mund të zgjasë për një ditë pa u rimbushur.

Ingranazhet “Ratnik” janë një grup pajisjesh shumëfunktionale e “ushtarit të së sotmes dhe së nesërme”. Personeli ushtarak i veshur me “Ratnik” do të jetë në gjendje të përballojë detyra të ndryshme, si zbulimi, eliminimi i armikut, sabotimi dhe të tjera.

“Ratnik-3” është një grup krejtësisht i ri i pajisjeve në aspektin e mbrojtjes, aftësive luftarake, mbështetjes për jetën, kontrollit dhe furnizimit me energji elektrike. Pllakat e blinduara të versionit aktual të ingranazhit, “Ratnik-2”, mund të përballojnë dhjetë të shtëna të shkrepura me një pushkë snajper në një distancë prej dhjetë metrash.

Sipas raporteve të mëparshme, grupi i ingranazheve do të jetë i njëjtë për trupat ajrore dhe tokësore. Vizori i “Ratnik-3” do të ketë një sistem synimi me lazer dhe ekzoskeleti aktiv do të rrisë aftësitë e sistemit lokomotor të ushtarit.

3. Teknologjia e Ushtarit të Integruar të së Ardhmes (Future Infantry Soldier Technology System-FIST)

Britania, si amerikanët dhe Rusia, filloi të mendonte për zhvillimin e uniformave ushtarake me fuqi të lartë në 2012! Por asgjë nuk ndodhi derisa u formua “Intelligent Textiles”. Sistemi FIST do t’i sigurojë ushtarit një ndërgjegjësim të përmirësuar të situatës në vdekshmëri dhe mbijetesë.

Sistemet do të vlerësohen në një masë të aftësive të përmirësuara dhe miqësisë së ushtarëve me lehtësi dhe komoditet operimi.

Pesë fushat kryesore të aftësive identifikohen si C4I (K4I-komandimi, kontrolli, komunikimi, kompjuterët dhe inteligjenca), vdekshmëria (armët dhe pamjet), lëvizshmëria (navigimi, madhësia dhe pesha e pajisjeve), mbijetesë (veshja, vjedhja, armatura e trupit) dhe qëndrueshmëria (konsiderata logjistike).



FIST përdor aftësi të zgjeruara komunikimi duke përfshirë zërin, të dhënat, imazhet dhe pajisjet e internetit. Sistemi ofron gjerësi bande adekuate për transferimin e vëllimeve të mëdha të informacionit taktik. Tekstilet e kamuflazhit më të butë do të ofrojnë qëndrueshmëri, mbrojtje të mjedisit dhe nënshkrim të reduktuar termik, ndërsa materialet e reja të përbëra ofrojnë forca të blinduara trupore të lehta dhe fleksibël.

4. Pajisjet e fantazisë me lidhje të integruara (Fantassin à Équipements et Liaisons Intégrés-FELIN)

Ushtria franceze kanë lançuar kostumin e tyre të betejës që duket shumë ndryshe nga tipi amerikan dhe britanik. Uniforma duket shumë e ngjashme me atë të rusëve “Ratnik Three”, ajo ka një sistem drejtimi vizioni që ndihmon një ushtar të sulmojë edhe në situata të vështira. Natyra e betejave FELIN, duket shumë e ngurtë si ato të përdorura në trillimet futuriste të luftës. Ai gjithashtu ka ekzoskelete të fuqizuar që mbrojnë kyçet e këmbëve dhe gjunjët, së bashku me një sistem

largimi të djersës. Materiali i përdorur për uniformën është shumë më afër një lloji jo teknologjie pasi mund të sprapsë ujin dhe insektet.

FELIN (Fantassin à Équipements et Liaisons Intégrés) është gjenerata e fundit e pajisjeve të ushtarëve të këmbësorisë së ardhshme të përdorur nga ushtria franceze. Projekti i sistemit FELIN u drejtua nga kompania franceze “Sagem” në partneritet me disa kompani franceze të mbrojtjes. Bazuar në një koncept modular, është i pajtueshëm me të gjitha operacionet luftarake (ditë, natë, i zbritur, i montuar në automjete dhe avionë, në ajër, në zona urbane, rurale ose të shkretëtë). Ai ofron konfigurime të shumta ushtarësh të përshtatur për profilet operacionale si: drejtues toge dhe seksioni, snajper, mitraloz, granatier. Gjatë një periudhe dyvjeçare nga viti 1999, prototipa të shumtë i janë dorëzuar Ushtrisë Franceze dhe Agjencisë së Prokurimit të Mbrojtjes së vendit (DGA) për të testuar performancën, ergonominë dhe aftësinë e FELIN për t’i bërë ballë kushteve të vështira.



Karakteristikat e përgjithshme

Pesha e sistemit: 24 kg për 24 orë luftime të zbritura në një konfigurim tipik granatieri, i cili përfshin pushkën e sulmit FAMAS dhe furnizimet ditore (d.m.th. ushqim, ujë, municione). Sistemi FELIN përfshin kompjuter portativ, një radio me zë dhe të dhëna, veshje të reja luftarake me armaturë trupi dhe një helm të re balistike. Sistemi FELIN është i kompletuar me një komplet integruar automjeti për VAB dhe VBCI me burime individuale energjie për të rimbushur bateritë, karikues baterish që mund të futen jashtë bordit dhe një funksion që sinkronizon sistemet e informacionit midis automjetit (SIT) dhe drejtuesve të seksioneve (SIT COMDE).

(vijon)

Kongresi antifashist i Përmetit, duke pasur parasysh përbërjen gjithëpërfshirëse të delegatëve të tij dhe përfaqësimin e tyre territorial, ishte një kuvend kombëtar apo një asamble kushtetuese që kishte misionin të zgjidhte organet legislative dhe ekzekutive, të cilat do të qeverisnin vendin deri në mbarim të luftës dhe më pas, në Shqipërinë e çliruar.

Vizioni demokratik dhe vendimet historike të Kongresit të Përmetit

Më 24 maj 1944 filloi punimet në Përmet Kongresi I Antifashist i Lëvizjes Nacionalçlirimtare shqiptare. Ne terminologjinë e shkurtuar historike, ky kuvend kombëtar njihet si Kongresi i Përmetit.

Kongresi ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe decizive të luftës antifashiste të popullit shqiptar, një kuvend që riformatoi dhe çimento vendimet dhe idetë paraprake që ishin hedhur në Konferencën e Pezës në shtator të vitit 1942.

Për më tepër, duke u mbështetur në hovin dhe iniciativën që kishte fituar tashmë lufta e reparteve partizane në veçanti dhe Lëvizja Antifashiste në Shqipëri; Kongresi i Përmetit saktësoi direktivat për kalimin në stadin final të kësaj lufte, çlirimin e plotë të atdheut. Vizioni i Kongresit shkoi përtej çlirimit të vendit, duke hedhur themelet për mënyrën e qeverisjes dhe duke përcaktuar se kush do të ishte forca që do të merrte në dorë pushtetin në Shqipërinë e lirë, pas shporrjes së pushtuesve gjermanë.

Natyrisht, me vendimet e rëndësishme që ndikuan në jetën dhe fatet e Shqipërisë për dekada të tëra nga ajo ditë, Kongresi I Përmetit ka zënë një vend të rëndësishëm në historinë shqiptare të pasluftës dhe në kujtesën e mbarë popullit shqiptar. Padyshim duhet përmendur se për shkak të kësaj ngjarjeje historike, 24 maji zuri një vend të veçantë në kujtesën e popullit të Përmetit.

Kushtet politiko-ushtarake për thirrjen e Kongresit të Përmetit

Lëvizja Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare (UNÇSH), ose forcat partizane, përballuan me sukses operacionin e dimrit (1943-44), që ishte një mësymje e koordinuar kundër tyre nga ushtria pushtuese gjermane dhe kolaboracionistët vendas. Propaganda e ushtrisë gjermane dhe ajo e qeverisë kuislinge të Tiranës deklaroronin në këtë kohë se rezistenca antifashiste dhe lufta partizane ishin asgjësuar.

Në të vërtetë, me gjithë humbjet që pësoi nga ky operacion, UNÇSH mbijetoi dhe u konsoliduar si forcë e rëndësishme luftarake. Në fillimet e pranverës 1944 ajo filloi të zgjerohej me shpejtësi dhe po shtrihej në të gjithë territorin shqiptar. Kështu, nga janari në maj të atij viti, UNÇSH-së iu shtuan brigada të tjera partizane e disa batalione e çeta lokale.

Vrullin e rritjes së lëvizjes partizane në këtë periudhë e përshkruan me përshtypje të veçantë në kujtimet e tij edhe oficeri i misionit aleat britanik në Shqipëri, kapiteni R. Hibbert. Në librin e tij "Fitorja e hidhur", që është botuar në vitin 1991, ai shkruan: "Zgjerimi i forcave partizane ose UNÇSH në pranverë ishte një dukuri e jashtëzakonshme, që i habiti oficerët e misionit britanik, të cilët kishin qenë dëshmitarë të situatës së rrezikshme që kishte kaluar bërthama e forcave partizane vetëm dy-tre muaj më parë". Me luftën e saj të ashpër kundrejt pushtuesit, organizimin e lartë dhe qëndrimin dashamirës ndaj popullit, UNÇSH fitoi besimin dhe mbështetjen popullore në Shqipëri.

Ajo shihej si e vetmja forcë shqiptare që luftonte për çlirimin e vendit, ringritjen e flamurit shqiptar dhe mbrojtjen e aspiratave e të të



drejtave për shumicën e popullsisë shqiptare. Të rinjtë dhe të rejat shqiptarë vërshuan dhe shtuan me shpejtësi rreshtat e formacioneve partizane.

Në fund të pranverës së vitit 1944 iniciativa ushtarake në Shqipëri kaloi në dorën e Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare; gjermanët dhe forcat kolaboracioniste u mbyllën kryesisht në garnizonet e qyteteve, sidomos në Shqipërinë e Jugut. Në planin ndërkombëtar situata gjithashtu ishte optimiste për koalicionin antifashist që udhëhiqej nga tri Fuqitë e Mëdha: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe SHBA.

Në përputhje me këtë situatë optimiste; për të bërë bilancin e arritjeve të LNÇ dhe për të përcaktuar objektivat dhe platformën për vazhdimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe qeverisjen e vendit, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi, më 15 prill 1944, thirrjen e Kongresit Antifashist të Përmetit.

Vendimet e Kongresit të Përmetit

Kongresi antifashist i Përmetit, duke pasur parasysh përbërjen gjithëpërfshirëse të delegatëve të tij dhe përfaqësimin e tyre territorial, ishte një kuvend kombëtar apo një asamble kushtetuese që kishte misionin të zgjidhte organet legislative dhe ekzekutive, të cilat do të qeverisnin vendin deri në mbarim të luftës dhe më pas, në Shqipërinë e çliruar. Ashtu siç dihet nga dokumentet historike, kongresi zgjodhi së pari Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KPNÇ) si organin më të lartë shtetëror; forumin kryesor ligjvënës, përfaqësuesin e vetëm sovran të popullit shqiptar.

KPNÇ zgjodhi Kryesinë e Këshillit të Përgjithshëm që përbëhej nga 25 anëtarë; president i saj u zgjodh Omer Nishani. Së treti, në Kongres u zgjodh dhe Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili kishte atributet e një qeverie

provizore. Ky komitet, apo qeveri provizore, përbëhej nga 11 anëtarë.

Sekretari i përgjithshëm i PKSH-së, Enver Hoxha, u emërua kryetar i qeverisë provizore, kurse nacionalisti i mirënjohur Myslim Peza u emërua nënkryetar i qeverisë provizore. KPNÇ, si organ ligjvënës, qysh në formimin e tij gjatë ditëve të Kongresit, nxori aktet apo vendimet e para të rëndësishme, të cilat patën një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të luftës çlirimtare dhe pavarësinë e Shqipërisë në vitet e mëvonshme.

Vlen të përmenden tri vendimet e mëposhtme, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën



Delegatë në Kongresin e Përmetit, Gaço Tashko, Zylyftar Veleshnja, Siri Shapillo, Gafurr Çomo, Manol Kononi, Sejfulla Malëshova, Gjergj Kokoshi, Spiro Koleka, Selim Shpuza, Halim Budo

politiko-ekonomike të Shqipërisë dhe përcaktuan drejtimin që do të merrte shteti i ardhshëm shqiptar: • Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike e popullore sipas vullnetit të popullit. • T'i ndalohej ish-Mbretit Zog kthimi në Shqipëri dhe të mos njihet asnjë qeveri që mund të formohej brenda ose jashtë vendit kundër vullnetit të popullit. • Të vazhdohet më me ashpërsi lufta kundër

pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqiptarë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik-popullor në të gjithë vendin.

Vendimet e Kongresit të Përmetit treguan se LNÇ dhe PKSH, si forca kryesore lëvizëse e saj, kishin krijuar bindjen se ato do të ishin fituesit e luftës dhe do të qeverisnin vendin pas fitores. Megjithatë ca vëzhgues të huaj e quanin si vetëbesim të tepruar optimizmin e drejtuesve të LNÇ në atë kohë, ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se analiza e situatës që beri PKSH dhe LNÇ ishte racionale dhe realiste.

Kongresi i Përmetit duke shpallur person "non grata" ish-Mbretin Zog i vuri atij legalisht damkën e tradhtarit, sepse ai e ktheu Shqipërinë në shtet vasal të Italisë dhe braktisi popullin e vendin (bashkë me shpurën e qeveritarëve të tij) në ditët e vështira të pushtimit fashist.

Gjithashtu, vendimet e këtij Kongresi u dhane një mesazh të qartë kuislingëve dhe kolaboracionistëve ballisto-zogistë; nuk do të kishte pushtet në tavolinë për ata që bashkëpunonin me armikun dhe as për ata që prisnin të ikte pushtuesi e pastaj "të luftonin". Pushteti u takonte atyre që luftonin kundër pushtuesit për çlirimin e Shqipërisë dhe do të mbronin lirinë, të drejtat, interesat dhe aspiratat demokratike të popullit shqiptar. Në zbatim të vendimit të Kongresit për çlirimin e plotë të Shqipërisë, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, më 28 maj 1944, nxori urdhrin për fillimin e ofensivës së përgjithshme ushtarake.

Në këtë kuadër, Divizionit I S, i cili sapo ishte formuar, iu komunikua detyra të kalonte Shkumbinin dhe të mësynte forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas në Shqipërinë e Mesme dhe Shqipërinë Veriore. Marshimi i Divizionit I drejt Veriut ishte një moment kyç në luftën për çlirim. Ai tregoi se tani UNÇSH ishte e aftë për të luftuar pushtuesit në çdo zonë të Shqipërisë, kishte marrë iniciativën luftarake kundrejt armikut dhe së shpejti objektivi i saj do të ishte çlirimi i qyteteve, përfshirë edhe Tiranën. Përfundimisht, edhe sot pas 77 vitesh, mbështetur në kohën kur u mbajt dhe vendimet e rëndësishme të tij, mund të thuhet se Kongresi i Përmetit zë një pikë kulmore në historinë shqiptare.

Aty u përcaktuan drejtimet për të realizuar qëllimin final të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar: çlirimin e plotë të atdheut nga pushtuesit nazifashistë, garantimin e një Shqipërie të lirë e sovranë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Krenarë për sukseset e atletëve të FA-së!

Një tjetër sukses për **Ilir Këllezin**, i cili triumfoi në gjysmë-maratonën e Kosturit duke u shpallur kampion në *"Run Greece 2022"*, si dhe kampion kombëtar në **10 000** metra për të pesëmbëdhjetin vit rresht. Krenarë për sukseset e vazhdueshme të atletëve të **FA-së!**



FORCA TOKESORE



Kontingjenti shqiptar që shërben në Komandën Rationale Perëndimore (RCW)-KFOR, përfundoi me sukses trajnimin mbi "Kontrollin e turmave gjatë ndërhyrjeve nga ajri", për rritjen e gatishmërisë dhe operacionalitetit gjatë kryerjes së misionit. Ky trajnim u zhvillua nën drejtimin e palës amerikane.



Efektivët e batalionit të Parë të Këmbësorisë, pjesëmarrës në stërvitjen "Efes-22" në Izmir, Turqi



Batalioni i Dytë i Këmbësorisë gjatë realizimit të qitjeve në Bizë



Ushtrime stërvitore të efektivëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me efektivët e Forcës Tokësore